



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

“Falimentimi ndërkombëtar- aspekti material dhe procedural”

KANDIDATI:

ELDITA JUSUFI

MENTORI:

Prof. Dr. ADNAN JASHARI

TETOVË, 2019

PËRMBAJTJA

LËNDA E HULUMTIMIT.....	6
QËLLIMET E HULUMTIMIT	7
HIPOTEZAT.....	7
1. Roli dhe rëndësia e falimentimit.....	8
2. Rregullimi i institutit të falimentimit.....	8
3. Kushtet për inicimin e procedurës së falimentimit.....	8
4. Analiza e rasteve të falimentimit	9
5. Të ndikohet në ngritjen e vetëdijës për mundësinë e hapjes së kësaj procedurë për të realizuar interesat e kreditorëve.	9
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	10
RËNDËSIA E PUNIMIT	11
 HYRJE.....	 12
 KREU I.....	 14
 NË PËRGJITHËSI MBI FALIMENTIMIN	 14
1. Kuptimi	14
2. Shkaqet e falimentimit.....	18
3. Vështrimi historik.....	22
4. Shkaqet e inicimit të procedurës së falimentimit në vendin tonë, rajon dhe në shtetet kryesore botërore	25

5. Trajtimi juridik i falimentimit në shtetet e sistemit anglosakson	33
5.1 Trajtimi juridik i falimentimit në SHBA	33
5.2 Trajtimi juridik i falimentimit në Mbretërinë e Bashkuar	36
6. Trajtimi juridik i falimentimit në shtetet e sistemit kontinental-evropian	38
6.1 Trajtimi juridik i falimentimit në Shqipëri dhe Kosovë	42

KREU II..... 47

FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR-ASPEKTI MATERIAL 47

1. Kuptimi	47
2. Shkaqet materiale për trajtimin e falimentimit ndërkombëtar	48
2.1. Pasuria e debitorit falimentues dhe pjesëmarrësit	48

FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR-ASPEKTI PROCEDURAL 48

1. Kuptimi.....	49
2. Kompetenca në bazë të pasurisë së debitorit të huaj falimentues.....	52
3. Zbatimi i parimit lex fori në procedurën e falimentimit.....	53

KREU III..... 55

SUPOZIMET DHE PRANIMI I VENDIMEVE TË HUAJA PËR HAPJEN E

PROCEDURËS FALIMENTUESE..... 55

1. Zbatimi i së drejtës kompetente.....	58
2. Propozimi për njohjen	61
3. Kushtet për njohjen	61

4. Procedura për njohjen e vendimit të huaj	63
5. Vlefshmëria e vendimit të huaj të pranuar për hapjen e procedurës së falimentimit	64
6. Njohja e vendimit të huaj në rast të hapjes paraprake të procedurës falimentuese në Maqedoninë e Veriut	65
7. Njohja pa pasoja nga hapja e vendimit të huaj në Maqedoninë e Veriut.....	66
8. Njohja e vendimit të huaj me pasoja për hapjen e procedurës falimentuese në Maqedoninë e Veriut	67
9. Hapja e procedurës së veçantë në Maqedoninë e Veriut si pasojë e njohjes së vendimit të huaj mbi hapjen e procedurës falimentuese	68
10. Mospranimi i vendimeve të huaja për hapjen e procedurës falimentuese	69
11. Falimentimi ndërkombëtar dhe plani për riorganizim	70
REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE NË LIDHJE ME	
FALIMENTIMIN NDËRKOMBËTAR	73
ZHVILLIMET E FUNDIT	75
KRIMI DHE FALIMENTIMI.....	79
 KREU IV	 81
1. Analiza e të dhënave empirike dhe statistikore në lidhje me falimentimin ndërkombëtar në RMV, nga viti 2017 e këndej.....	81
PËRFUNDIMI	85
BIBLIOGRAFIA	88

ABSTRAKT

Falimentimi paraqet një dukuri me rëndësi të madhe në lëmin e zhvillimit të ndërmarrjeve tregtare në veçanti dhe të zhvillimit ekonomik të një vendi në përgjithësi. Nëse e konsiderojmë se fjala “falimentim” domethënë dështim, atëherë padyshim se na duhet një qasje sa më serioze ndaj këtij fenomeni me qëllim të gjetjes së shkaqeve që çojnë deri tek shkatërrimi i ndërmarrjeve.

Punimi im i jep një rëndësi të veçantë dhe synon të trajtojë në menyrë të detajuar falimentimin në përgjithësi duke sqaruar pikat kyçe të kësaj dukurie (çka në të vërtetë paraqet ai) dhe falimentimin ndërkombëtar i cili në vete kërkon involvim ligjor ndërkombëtar.

Shpresoj se argumentet e ofruara do të sqarojnë në masë të duhur këtë fenomen dhe se punimi sadopak do të ndikojë në trajtim të mëtutjeshëm të falimentimit.

Fjalët kyçe: Falimentim, falimentim ndërkombëtar, debitor, kreditor, etj.

ABSTRACT

Bankruptcy is a phenomenon of great importance in the development of commercial enterprises in particular and of the economic development of a particular country in general. If we consider the word "bankruptcy" to mean failure, then we obviously need a more serious approach to this phenomenon in order to find causes that lead to the destruction of enterprises.

My paper aims to address bankruptcy in general by clarifying the key points of what it actually represents, with particular emphasis on international bankruptcy which in itself requires international legal involvement.

I hope that the arguments provided will adequately explain this phenomenon and that the work will somehow affect further treatment of bankruptcy.

Key words: Bankruptcy, international bankruptcy, debtor, creditor, etc.

LËNDA E HULUMTIMIT

Lënda e këtij hulumtimi është e përbërë prej më tepër elementeve dhe është komplekse. Në qendër të punimit vë institucionin e falimentimit, duke hulumtuar të gjitha çështjet lidhur me të si: falimentimin në përgjithësi (kuptimi), shkaqet e inicimit të procedurës, vështirimin historik, falimentimin ndërkombëtar si dhe njohjen e vendimeve të huaja. Do ta sqarojmë falimentimin si institut nga aspekti i së drejtës tregtare, nga aspekti i së drejtës ndërkombëtare private, sepse falimentimi ndërkombëtar në vete përmban element të huaj, prandaj kërkon edhe involvimin e kësaj dege të së drejtës që ta qartësojmë më mire si dhe do ta sqarojmë ngapak edhe nga aspekti ekonomik.

Falimentimi si institut juridik ka qenë prezent edhe në të drejtën romake. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut instituti i falimentimit është rregulluar me ligjin për falimentim i cili në mënyrë të hollësishme e ka rregulluar këtë institut. Me këtë ligj përcaktohen qëllimet dhe arsyet e hapjes së procedurës falimentuese, mënyrën e zhvillimit të procedurës, pasojat juridike nga inicimi i kësaj procedure, etj...¹

Ndërsa burimet ndërkombëtare në të drejtën e falimentimit janë të shumta dhe ne i njohim si marrëveshje bilaterale (në mes dy shteteve) dhe multilaterale (në mes më shumë shteteve).² Ndikim të madh në legjislacionet nacionale kanë pasur burimet kryesore si:

a) Konventa evropiane mbi aspektin ndërkombëtar të falimentimit, e nxjerrë nga Këshilli i Evropës; dhe

b) Rregullativa e UE nr:1346/2000 mbi procedurën falimentuese.³

¹ Jashari, A (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq 337

² Po aty, fq 339

³ Po aty

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Falimentimi paraqet një institut kryesor në funksionimin e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim kryesor që t'i largojë nga tregu subjektet që janë jo profitabil. Ky institut është shumë i përhapur në RMV, prandaj është e nevojshme që të bëhet një sqarim më i thellë i këtij instituti në përgjithësi, të sqarohen shkaqet dhe kushtet që duhet të ekzistojnë për të inicuar një procedurë të tillë, të sqarohet falimentimi ndërkombëtar, njohja e vendimeve të huaja si dhe plani për riorganizim. Poashtu, duhet të analizohen të dhënat e ndryshme dhe të nxirren konkluzione mbi rastet (me element të huaj) që kanë inicuar procedurë falimentimi në RMV si dhe të analizohen kushtet dhe shkaqet që kanë dërguar në inicim të kësaj procedure në rastet konkrete.

Sqarimi i kësaj procedure dhe çështjeve që ndërlidhen me të, do të mundësojë që të kemi një pasqyrë sa më të qartë se si duhet vepruar nëse një ndërmarrje ballafaqohet me këtë fenomen, por çka është ndoshta edhe më e rëndësishme, do të ofrojë pikëpamje të cilat do të evitojnë që një kompani të mos bjerë në grackën e falimentimit.

Shpresojmë që duke ofruar argumente dhe sqarime të mjaftueshme do të arrim qëllimin tonë.

HIPOTEZAT

1. Roli dhe rëndësia e falimentimit

Së pari do të duhet të trajtojmë rolin dhe rëndësinë e fenomenit në fjalë me qëllim që ta kemi më lehtë sqarimin e pasojave, qofshin ato pozitive apo negative që rezultojnë nëse një ndërmarrje e caktuar do të ballafaqohet me procedurën falimentuese. Në këtë drejtim, besoj se argumentet e ofruara do të jenë sqaruese në masë të duhur me qëllim që lexuesi t'i kuptojë sa më lehtë hipotezat të cilat do të vijojnë.

2. Rregullimi i institutit të falimentimit

Siç e dimë të gjithë, çdo procedurë, qoftë ekonomike apo juridike e cila në vete ngërthen palë të ndryshme fiziko-juridike, padyshim se kërkon edhe rregullativa konkrete të cilat kanalizojnë fushëveprimin e palëve të involvuara. Ligjet kombëtare apo ndërkombëtare, rregulloret e shumta të miratuara në lidhje me dukurinë e falimentimit gjithsesi se në masë të madhe lehtësojnë ecurinë drejt gjetjes së zgjidhjes adekuate për rastet konkrete të një falimentimi të caktuar. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur kemi të bëjmë me çështjen e falimentimit ndërkombëtar, që në vete involvon procedura ndërkufitare të cilat kërkojnë një qasje mirë të definuar.

3. Kushtet për inicimin e procedurës së falimentimit

Proceset serioze, në të cilat padyshim se bën pjesë edhe procedura e falimentimit, padyshim se nuk mund të inicohen vetëm sipas dëshirës të njëjës apo tjetrës palë pa plotësuar kushtet ligjore. Inicimi i një procedure falimentuese kërkon plotësimin e kushteve të caktuara (që besoj se i kemi sqaruar qartë në këtë hulumtim). Secili rast i falimentimit i ka specifikat e veta prandaj është e nevojshme që secili rast konkret të ketë trajtim të mirëfilltë.

4. Analiza e rasteve të falimentimit

Çdo punim hulumtues kërkon që në sasi më të vogël apo më të madhe të përmbajë të dhëna të cilat do të pasqyrojnë me qartë dukurinë e cila është objekt hulumtimi. Rastet konkrete nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull, prandaj duke ofruar të dhëna në lidhje me falimentimin ndërkombëtar të ndërmarrjeve që involvojnë edhe Maqedoninë e Veriut, besoj se do ta kemi më të qartë se si zhvillohet një procedurë e caktuar falimentimi.

5. Të ndikohet në ngritjen e vetëdijës për mundësinë e hapjes së kësaj procedure për të realizuar interesat e kreditorëve.

Çdo hulumtim në një masë të caktuar ka për qëllim që të ndriçojë objektin i cili hulumtohet, të qartësojë një dukuri komplekse siç është falimentimi dhe në këtë mënyrë t'u ndihmojë palëve të involvuara që të realizojnë qëllimet dhe detyrimet ashtu që procedura të përmbyllet me sukses. Kjo posaçërisht është e rëndësishme për t'u ndihmuar kreditorëve të cilët mund të themi se më së shumti janë të ndikuar nga falimentimi i një ndërmarrjeje të caktuar.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë punim do të përdoren metoda dhe teknika të ndryshme shkencore hulumtuese. Në varësi nga lënda dhe qëllimi i hulumtimit i përmendur më lartë, metodat e përgjithshme shkencore që do të përdoren janë:

- Metoda deskriptive-përshkruese – ku me anë të përshkrimit të rasteve dhe dukurive konkrete do të mundohemi të qartësojmë objektin që e kemi si lëndë studimi, duke lehtësuar kështu kuptimin e koncepteve që i ngërthen një procedurë falimentimi.
- Metoda deduktive – me anë të së cilës objektin e hulumtimit e kemi ndarë në pjesë më konkrete me qëllim që të ofrojmë sqarime më detajore të pjesëve dhe në atë mënyrë të përfitojmë një pasqyrë të qartë të fenomenit si një tërësi.
- Metoda analitike – duke analizuar të dhënat në lidhje me falimentimin besoj se kam ofruar shpjegime më të konkretizuara të cilët mbështesin përfundimet e arritura sa më mirë që mundet.
- Metoda cilësore – është shfrytëzuar për të ofruar hulumtim cilësor nga burime të dëshmuara.
- Metoda sasiore – është shfrytëzuar për të ofruar numër të konsiderueshëm pikëpamjesh dhe të dhënash, të gjitha me qëllim që hulumtimi të jetë sa ma konkret dhe të realizohet qëllimi i sqarimit dhe trajtimit të fenomenit të falimentimit.
- Statistika – e cila paraqet bërthamën e çdo hulumtimi, do të ofrojë mbështetje kontekstuale për shqyrtimin e falimentimit në përgjithësi dhe falimentimit ndërkombëtar në veçanti.

Përveç këtyre metodave, gjithashtu shfrytëzohen edhe metoda dhe qasje metodologjike me ndihmën e të cilave arrihet deri në përfundime, analiza, sinteza, konkretizim e gjeneralizim, e gjitha me qëllim që sa më thellë t'i qasemi analizimit të funksionimit të institutit të falimentimit.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Ky hulumtim shkencor ka rëndësi të madhe në kushtet në të cilat jetojmë sot. Këto kushte imponojnë efikasitetin, si një veti përcjellëse të sjelljes në rrethana bashkëkohore. E famshme është thënia “time is money”, e cila më shumë se kurdo më herët gjen zbatim në çdo pore të jetës së përditshme dhe e cila më mirë përshkruan vlerën e kohës dhe çmimin e saj. Nga ky imponim nuk është kursyer as zbatimi i së drejtës nga ana e gjykatave shtetërore, që përkundrazi, si asnjëherë më parë është ngadalësuar. Si kundërpërgjigje ndaj punës së gjykatave shtetërore dhe si kërkesë e kohës në të cilën jetojmë, falimentimi gjen vendin e vet të merituar si instrument i shpejtë dhe efikas i drejtshmërisë dhe pastrimit të tregut nga subjektet jo profitabile.

Andaj, rëndësia e këtij punimi shihet në tendencën për të analizuar dhe për të nxjerrë në pah të gjitha përparësitë e përdorimit të institutit të falimentimit.

Njëkohësisht, duke u thelluar në analizimin dhe trajtimin e përparësive, punimi ka për qëllim të njoftojë publikun, aq më tepër palët procedurale, më për së afërmi me pasojat e shfrytëzimit të këtij institucioni në zgjidhjen e kontesteve të tyre, veçanërisht përfitimet në rastet e zgjidhjes së kontesteve me vlerë të madhe.

Në fund, përmes vlerësimeve personale do të mundohem të jap e të dëshmoj mendimin tim për perspektivat e falimentimit.

HYRJE

Shmangia nga dështimi i njësive ekonomike padyshim se është një nga çështjet më të rëndësishme që duhet trajtuar dhe vlerësuar në lëmin e drejtimit financiaro – ekonomik dhe juridik. Studimet e ndryshme në këtë fushë kanë shfaqur interes gjithnjë e në rritje për një numër të madh hulumtuesish shkencorë për arsye të llojllojshme. Në plan të parë në kontekstin e dështimit të një njësie ekonomike përfshihen një numër i konsiderueshëm i të ashtuquajturave grupe interesi. Së dyti, kur kemi të bëjmë me kostot direkte apo indirekte të falimentimit të njësisë ekonomike, padyshim se janë shumë të larta, edhe pse lartësia e atyre kostove varet kryesisht nga përmasat që mund të ketë një ndërmarrje e caktuar. Pastaj, të qenit në dispozicion e të dhënave dhe avancimi i teknikave të ndryshme hulumtuese ka rritur mundësitë e kërkuesve shkencorë për të ndërtuar modele të ndryshme të cilat do të ndihmojnë në parashikimin e falimentimit të njësive afariste. Punimi im fokusohet në dukurinë e falimentimit të njësive ekonomike si fenomen mjaftë i përhapur, e me theks të veçantë mbi falimentimin ndërkombëtar duke studiuar shkaqet që çojnë njësitë ekonomike drejt falimentimit si dhe faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në falimentim.⁴

Në vazhdimësi, në këtë punim do të jap edhe rekomandime që besoj se do të ofrojnë ndihmë për tejkalimin e disa pengesave të cilat bllokojnë hetimin e problemeve të cilat në një mënyrë apo tjetrën do të dërgojnë në falimentim.

Rezultatet e hulumtimeve të ndryshme të ndërtuara tregojnë se çështjet që më së shumti ndihmojnë për të klasifikuar njësitë ekonomike si të falimentuara apo të jo falimentuara, në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me raportet e përfitueshmërisë, raportet e aktivitetit dhe raportet e strukturës financiare.⁵

Një çështje tjetër që duhet përmendur është fakti se të gjitha indikatorët falimentues, të cilët janë kompleks në shikim të parë, bëhen edhe më të ndërlikuar kur kemi të bëjmë me falimentimin ndërkombëtar nga vet fakti se në atë rast kemi involvim të legjislatrave të shteteve të ndryshme.

⁴ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq.4

⁵ Po aty

Në bazë të zhvillimeve të viteve të fundit, lirisht mund të thuhet se studimi i falimentimit paraqet një ndër çështjet më të rëndësishme në lëmin e fenomeneve juridike dhe ekonomike. Kjo vjen si rrjedhojë e asaj që si pikë e parë, dështimi i ndërmarrjeve afariste ndikon direkt në planin ekonomik të një vendi në tërësi, si rrjedhojë e pasojave negative që një dukuri e tillë mund t'ju sjellë palëve të ndryshme të involvuara si: aksionerëve, kreditorëve dhe punonjësve të zakonshëm. Së dyti, shpenzimet për të menaxhuar një dukuri të tillë rriten deri sa të përfundojë e gjithë procedura falimentuese; ato kanë një rritje shkallëzore deri në momentin e afrimit të falimentimit.⁶

Sidoqoftë, shpresoj se punimi im do të ndriçojë këtë dukuri me rëndësi kyçe dhe sadopak do të ndihmojë në gjetjen e mënyrave adekuate për të evituar falimentimin e njësive ekonomike, qofshin të vogla apo të mëdha.

⁶ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq.13

KREU I

NË PËRGJITHËSI MBI FALIMENTIMIN

1. Kuptimi

Në fillim, falimentimin mund ta konsiderojmë si një dukuri e cila edhe pse ka filluar vonë të studiohet nëse e krahasojmë me dukuritë e tjera nga pikëpamja financiare dhe juridike, megjithatë është shfaqur dhe në vazhdimësi ka ndjekur veprimtarinë e njësive ekonomike. Humbjet dhe kostot që shkaktohen nga falimentimi janë të konsiderueshme dhe prekin jo vetëm njësinë ekonomike, por edhe çdo grup tjetër që mund të jetë i prekur nga ky fenomen si klienti, kreditori, investitori, etj...⁷

Falimentimi konsiderohet si mënyrë gjyqësore e ndërprerjes së shoqërisë tregtare në rastet kur të njëjtat punojnë me humbje dhe nuk kanë kapacitet për të përmbushur kërkesat ndaj kreditorëve të tyre. Në rastet e këtilla themi se debitori konsiderohet financiarisht debitor josolvent. Për t'u realizuar një përmbushje kolektive të debitorëve dhe kreditorëve, inicohet procedura falimentuese. Fillimisht bëhet shndërrimi në para i pasurisë së debitorit e pastaj realizohet shpërndarja e asaj pasurie ndaj kreditorëve, në forma të përcaktuara paraprakisht me ligj. Me këtë proces, në njëfar mënyre krijohen kushte për të kontrolluar pasurinë e debitorit falimentues duke pamundësuar kështu humbjet e mëtejme.⁸

Nga një pikëpamje tjetër, falimentimi krijon mundësi tjera për investitorët nga fakti se çmimet blerëse të sendeve që paraqiten në masë falimentuese janë më të ulta. Nga pikëpamja juridike, falimentimi si institut ka qenë i pranishëm që nga e drejta romake, ku është konsideruar si masë me anë të së cilës kreditori i debitorëve të stërngarkuar ka mundur ta shfrytëzojë dhe është e njohur si *missio in bona* dhe *cessio bonorum*. Me të parën, pretori ka lëshuar kreditorin në pasurinë e debitorit me qëllim që t'i konfiskojë dhe nga shitja e tyre të realizojë kërkesën e vet. Me të dytën, debitori

⁷ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 22

⁸ Jashari, A. (2012); *E drejta afariste (statusore)*; Tetovë; fq. 337

në mënyrë të vullnetshme ja ka dorëzuar pasurinë e vet kreditorit duke shpëtuar kështu nga burgimi dhe duke ruajtur nderin.⁹

Mungesa e suksesit tek njësitë ekonomike është përkufizuar në mënyra të ndryshme. Shumica e studiuesve për falimentimin shpesh shfrytëzojnë edhe termin dështim, vështirësi financiare, paaftësi paguese dhe mosshlyerje e huave. Edhe përkundër faktit se këto terma shpesh janë përdorur si sinonime të njëri – tjetrit, prap se prap ndryshojnë në mes veti.¹⁰

Disa studiues e përkufizojnë dështimin sipas kriterit ekonomik, sipas të cilit “norma e realizuar e kthimit mbi kapitalin e investuar, pas rregullimit me rrezikun, është në mënyrë të ndjeshme dhe të vazhdueshme më e ulët se norma aktuale e kthimit nga investime të ngjashme”.¹¹ Vendimi nëse njësi ekonomike do të vazhdojë aktivitetin e saj varet nga norma e pritur e kthimit dhe mundësia e saj për të mbuluar kostot e ndryshueshme.¹² Ndërsa, në qoftë se njësi ekonomike nuk është në gjendje të mbulojë këto kosto të prodhimit dhe koston e kapitalit, sipas disa të tjerëve njësi ekonomike mund të vazhdojë aktivitetin vetëm me miratimin e investitorëve të saj, nëse ata janë të gatshëm të pranojnë norma më të ulta kthimi. Nga ana tjetër, një njësi ekonomike që ndodhet në situatën e mësipërme, mund të mos ketë probleme financiare, që do të thotë se ajo mund të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet në momentin e maturimit të tyre.¹³

Nga pikëpamja financiare, dështimi mund të përkufizohet si mungesa e aftësisë së njësisë ekonomike për të shlyer detyrimet afatshkurtra në momentin e maturimit të tyre. Këto detyrime mund të përfshijnë detyrime të papaguara ndaj furnitorëve, detyrime të papaguara ndaj punonjësve, mospagesë në kohë të shpenzimeve të interesit, si dhe humbjet nga procedurat gjyqësore.¹⁴

⁹ Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 337

¹⁰ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 25

¹¹ Altman, E.I.; Hotchkiss, E. (2005); *Corporate Financial Distress and Bankruptcy: Predict and Avoid Bankruptcy, Analyze and Invest in Distressed Debt*; fq. 9

¹² Gaughan, P. A. (2011); *“Mergers, Acquisitions and Corporate Restructuring”*, 3. Edition, John Wiley and Sons Inc.; New York; fq. 58

¹³ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 25

¹⁴ Wruck, K. H. (1990); *“Financial Distress, Reorganization and Organizational Efficiency”*; Journal of Financial Economics, 27; fq. 419

Në një numër të konsiderueshëm studimesh aspekti i mungesës së mjeteve monetare është përdorur si një tregues i dështimit financiar. Disa studiues të kësaj fushe përdorin treguesin e mjeteve monetare dhe të vlerës së tregut të njësisë ekonomike për të identifikuar kur njësia ekonomike ndodhet në situatën e vështirësisë financiare. Sipas tyre, “vështirësia financiare” është një situatë ku njësia ekonomike nuk ka mjete të mjaftueshme monetare për të përballuar detyrimet dhe ajo pëson një rënie në vlerën e saj të tregut.¹⁵ Por, mungesa e mjeteve monetare të njësisë ekonomike mund të jetë e përkohshme dhe situata mund të përmirësohet duke përdorur disa alternativa, si reduktimi i nivelit të inventarit, zgjatja e termave të kredisë tregtare, ristrukturimi i detyrimeve përpara dështimit, shtimi i kapitalit dhe likuidimi i aktiveve të papërdorshme. Nëse situata financiare e ndërmarrjes nuk tregon përmirësim si rezultat i këtyre alternativave, atëherë padyshim se hasim në dukurinë e falimentimit.¹⁶

Është e rëndësishme të thuhet se dështimi financiar nuk është sinonim i falimentimit apo likuidimit, por teoritikisht të gjitha njësitë ekonomike mund të preken nga dështimi financiar apo ekonomik. Për më tepër, të tjerë theksojnë rëndësinë e dallimit ndërmjet dështimit financiar dhe dështimit ekonomik. Ata e përcaktojnë dështimin financiar si paaftësi të njësisë ekonomike për të shlyer detyrimet dhe dështimin ekonomik si humbje të vazhdueshme operative.¹⁷

Një term tjetër që përshkruan performancën negative të njësisë ekonomike është “paaftësia paguese”. Një njësi ekonomike mund të klasifikohet në situatën e paaftësisë paguese, nëse ajo nuk është e aftë të shlyejë detyrimet e saj, duke përfshirë detyrimet ndaj punonjësve, furnitorëve, kreditorëve, publikut dhe shpenzimet aktuale ose të mundshme nga çështjet gjyqësore. Më përpara, ky term është përdorur nga studiues sipas të cilëve, për të përshkruar gjendjen e paaftësisë paguese duhet përdorur raporti i fluksit të mjeteve monetare neto ndaj detyrimeve afatshkurtra.¹⁸

¹⁵ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 26

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

¹⁸ Po aty

Disa studiues e kategorizojnë paaftësinë paguese në paaftësi paguese të bazuar në aksione dhe paaftësi paguese të bazuar në mjetet monetare.¹⁹ Paaftësia paguese e bazuar në aksione ndodh kur vlera e tregut e aktiveve të njësisë ekonomike është më e vogël se vlera nominale e detyrimeve të saj. Ndërsa paaftësia paguese e bazuar në mjetet monetare ndodh kur njësia ekonomike nuk ka likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar detyrimet e saj afatshkurtra dhe kjo njihet si paaftësi paguese teknike. Gjendja e paaftësisë paguese teknike mund të jetë një situatë e përkohshme, edhe pse shpesh është shkak i deklarimit të falimentimit të njësisë ekonomike.²⁰

Një koncept tjetër financiar, i cili është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me vështirësinë financiare është “mosshlyerja e huave”. Dukuria e tillë mund të përshkruhet si një situatë në të cilën njësia ekonomike nuk është në gjendje të paguajë në datën e maturimit principalin dhe/ose interesat ndaj kreditorëve dhe rrjedhimisht, ajo shkel një kusht të marrëveshjes me kreditorin/kreditorët, që mund të jetë një shkak për hapjen e procedurave të falimentimit të njësisë ekonomike. Studiues të ndryshëm kanë identifikuar dy forma të vështirësisë financiare: forma e parë është situata e mosshlyerjes së principalit dhe shpenzimeve të interesit dhe forma e dytë është përpjekja për të ristrukturuar borxhin, me qëllim të parandalimit të situatës së mosshlyerjes së huasë. Falimentimi është një tjetër koncept i lidhur me vështirësinë financiare. Një lloj i falimentimit i referohet nivelit të vlerës neto të njësisë ekonomike, sipas së cilës një njësi ekonomike cilësohet e falimentuar nëse vlera neto e saj është negative. Lloji tjetër është kërkesa formale e falimentimit të njësisë ekonomike drejtuar gjykatës, e shoqëruar me kërkesën për të likuiduar aktivet ose për të ristrukturuar njësinë ekonomike.²¹ Ristrukturimi është një përpjekje formale e njësisë ekonomike për të parandaluar mbylljen përfundimtare të njësisë ekonomike, ndërsa likuidimi nënkupton shitjen e aktiveve të njësisë ekonomike në përputhje me ligjin për

¹⁹ Wruck, K. H. (1990); “*Financial Distress, Reorganization and Organizational Efficiency*”, Journal of Financial Economics, 27; fq. 423

²⁰ Altman, E.I.; Hotchkiss, E. (2005); *Corporate Financial Distress and Bankruptcy: Predict and Avoid Bankruptcy, Analyze and Invest in Distressed Debt*; fq. 9

²¹ Altman, E.I.; Hotchkiss, E. (2005); *Corporate Financial Distress and Bankruptcy: Predict and Avoid Bankruptcy, Analyze and Invest in Distressed Debt*; fq. 11

falimentimin dhe shpërndarjen e të ardhurave të realizuara tek kreditorët dhe grupet e tjera të interesit.²²

2. Shkaqet e falimentimit

Që një biznes të ketë sukses duhet t'i nxit përparësitë e tij. Dhe e kundërta, duhet t'i eliminoj anët e dobëta, gjegjësisht mangësitë. Suksesi dhe dështimi i ndërmarrjeve varet nga kombinimi i ndikimeve të brendshme dhe të jashtme, kështu, të suksesshmet faktikisht i njohin mundësitë dhe me ndihmën e anëve të forta të tyre i shfrytëzojnë, ndërsa u shmangen pengesave. Ndërmarrjet të cilat nuk reagojnë në këtë mënyrë, me kalimin e kohës bëhen të pasuksesshme, dhe në fund falimentojnë. Nëse një biznes është i suksesshëm, ajo do të thotë se mirë i ka shfrytëzuar përparësitë, domethënë anët e forta.²³ Mirëpo, duhet ditur se edhe në biznesin e tillë ekzistojnë dobësi, edhe pse të njëjtat janë në masë më të vogël. Shumica e autorëve që kanë analizuar shkaqet e falimentimit të njësive ekonomike kanë konstatuar se ata janë të shumta. Disa prej tyre theksojnë rëndësinë e faktorëve jo financiarë (Baum dhe Mezias, 1992; Greening dhe Johnson, 1996), ndërsa autorë të tjerë theksojnë faktorët financiarë (Myers dhe Majluf, 1984). Charan dhe Useem (2002) kanë përcaktuar drejtimin e njësive ekonomike, si përgjegjës kryesor të falimentimit. Sipas tyre janë gabimet e drejtimit ato që i kanë çuar më shumë njësitë ekonomike drejt mbylljes së aktivitetit të tyre. Morris (1997) është një autor tjetër që ka studiuar shkaqet e falimentimit të njësive ekonomike, i cili arriti në përfundimin se edhe pa analizuar treguesit financiarë mund të merret një informacion i vlefshëm për ecurinë e njësive ekonomike.²⁴

Të shohim çfarë mund të paraqes mangësi për një ndërmarrje të suksesshme dhe t'i krijoj probleme në të ardhmen.

²² Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 28

²³ Charan, R.; Useem, J. (2002); *Why companies fail - CEOs offer every excuse but the right one: their own errors*; *Fortune*; fq. 52

²⁴ Po aty

Mungesa e hapësirës dhe e mundësive prodhuese – në shumë raste ndërmarrjet që kanë sukses ballafaqohen me mungesën e hapësirës ose ndonjë mungesë tjetër prodhuese, për shembull, një fabrikë e vogël për konfeksion e cila punon suksesshëm, ballafaqohet me mungesë të hapësirës së depos. Ose, ndërmarrja e njëjtë nuk mund të pranoni porosi më të madhe, nga fakti se i mungojnë mjetet e duhura për punë.²⁵

Vjetërsimi (amortizimi) i resurseve – padyshim se resursi më i rëndësishëm që vjetërsohet është vet njeriu duke i radhitur më pas edhe ndërtesat, makinat, pajisjet, etj... Për një kompani të suksesshme, dobësi është puna në një ndërtesë të vjetër sepse për mirëmbajtjen e vendit të punës në fjalë shpenzohet më tepër, pra kjo shkakton zmadhim të shpenzimeve prodhuese. Gjithsesi se hapësira e vogël jep mundësi për qira më të vogla.²⁶

Kur kemi të bëjmë me fenomenin njeri, dobësi tepër e madhe është nëse struktura e moshës së të punësuarve është e pavolitshme (mendohet në numrin më të madh të të punësuarve të moshuar). Strukturë ideale e të punësuarve do të ishte ajo ku shumica e të punësuarve janë në të a.q. moshë të mesme. Mirëpo, nuk ekziston rregull për atë se cila moshë e të punësuarve do të konsiderohej si më e volitshme, ngase secila formë biznesi ka kërkesat e veta specifike që e dallojnë nga të tjerat.²⁷

Mungesë e kuadrit të kualifikuar – mund të themi se edhe ato ndërmarrje të cilat i konsiderojmë si më të suksesshme, si mungesë e konsiderojnë faktin se gjithë menaxherët ose të punësuarit nuk janë “më të mirët”, gjegjësisht nuk janë me kualifikime më të mira. Prandaj, detyrë e menaxherëve është t’i identifikojnë këto dobësi dhe të mundohen t’i minimizojnë: të pranojnë puntorë të ri në ato vende të punës në të cilat të punësuarit ekzistues nuk janë me kualifikime të përshtatshme ose të punojnë në drejtim të rikualifikimit.²⁸

²⁵ Velkova, S. (2010); *Biznesi për vitin IV*; Shkup; fq. 55

²⁶ Po aty

²⁷ Po aty

²⁸ Po aty

Atraktiviteti i produktit – askush nuk mund të pret që një produkt të jetë atraktiv për një periudhë më të gjatë, sepse në treg vazhdimisht paraqiten produkte të reja. Gjithashtu, dëshirat, nevojat dhe interesat e shpenzuesve vazhdimisht ndryshojnë. Nga këtu, si dobësi e një biznesi mund të konsiderohet prodhimi dhe ofrimi i produkteve jokualitative apo që nuk janë në trend me kërkesat konkrete të konsumatorëve.²⁹

Probleme financiare – secila ndërmarrje qoftë e suksesshme apo jo, në një moment apo tjetrin has në probleme financiare në aspekt të mungesës së parave për pagesë të obligimeve. Kjo është dobësi primare që ndërmarrja duhet dhe mundet ta anashkalon. Këtu mund të përmendim marrjen e kredive apo huazimin nga subjekte tjera, etj.³⁰

Lokacion i papërshtatshëm – një çështje tjetër e cila mund të jetë mjaftë e rëndësishme, është lokacioni i ndërmarrjes. Nëse gjendet larg nga burimi i lëndëve dhe materialeve, ose nga tregu në të cilin i ofron produktet e gatshme, në atë rast, ndërmarrja do të bënte shpenzime të mëdha transportuese gjatë furnizimit të lëndëve dhe materialeve, gjegjësisht gjatë dërgesës së produkteve deri tek vendet ku bëhet shitja.³¹

Një shkak tjetër mund të jetë **mungesa e planit të biznesit** të njësisë ekonomike. Sipas disa studiuesve, një njësi ekonomike mund të falimentojë edhe nëse produkti/shërbimi i saj ka kërkesë në treg. Në këtë rast falimentimi mund të vijë nga pritshmëritë jorealiste të rritjes dhe nga planifikimi jo i duhur. Si rrjedhojë, njësi ekonomike mund të gjendet në situatën e mungesës së mjeteve monetare, duke qenë se niveli aktual i përfitueshmërisë nuk është në gjendje të mbështesë strukturën e mëparshme të kapitalit, e cila është ndërtuar duke u bazuar në nivelin e parashikuar të përfitueshmërisë.³²

Këto shembuj tregojnë se mbijetesa dhe zhvillimi i biznesit nvaren nga faktorët e rrethinës. Domethënë, ato ndërmarrje të cilat nuk i dinë anët e tyre të forta dhe të dobëta, të cilat nuk i ndjekin ndryshimet në rrethinë dhe i injorojnë mundësitë dhe

²⁹ Velkova, S. (2010); *Biznesi për vitin IV*; Shkup; fq. 55

³⁰ Po aty

³¹ Po aty

³² Moyer, S. (2005); *Distressed Debt Analysis*; Boca Raton; fq. 113

pengesat, përballen me kërcënimin që për kohë të shkurtër të ndalojnë së punuari. Disa autorë tjerë e kanë studiuar parashikimin e falimentimit të njësive ekonomike nëpërmjet analizës logit.³³ Ata në studimin e tyre kanë përfshirë 4796 njësi ekonomike belge, prej të cilave 826 prej tyre kishin shpallur falimentimin gjatë periudhës 2010 – 2014. Të dhënat në lidhje me raportet financiare dhe karakteristikat e njësive ekonomike të përfshira në studim janë marrë nga “Bureau Van Dijk”.³⁴

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se probabiliteti i falimentimit të njësive ekonomike rritet me uljen e nivelit të likuiditetit të aftësisë paguese dhe të përfitueshmërisë. Një nga studimet më të fundit në lidhje me parashikimin e falimentimit të njësive ekonomike është kryer edhe nga Alaminos, Castillo dhe Fernandez (2016). Në punimin e tyre janë përfshirë 440 njësi ekonomike të kuotuar në tre rajone: Azi, Europë dhe Amerikë.³⁵

Poashtu edhe autorë tjerë në punimet e tyre vlerësojnë vetëm kostot profesionale në lidhje me falimentimin. Për këtë, ata përfshijnë në studim 48 njësi ekonomike të falimentuara në Delaware dhe në Nju Jork.³⁶ Vlera mesatare e aktiveve të këtyre njësive ekonomike në momentin e hapjes së procedurave të falimentimit ishte 480 milionë dollarë. Rezultatet e studimit tregojnë se kostot profesionale arrijnë në 1.4% të vlerës së aktiveve në momentin e fillimit të procedurave të falimentimit.³⁷

Autorë tjerë për studimin e tyre u bazuan në 500 njësitë ekonomike të bursës Standard & Poor’s, ndërkohë për ndërtimin e modelit kampioni u reduktua në 221 njësi ekonomike. Sipas studimit të tyre, kostot e falimentimit janë më pak se 10% në sektorin e gazit dhe të energjisë dhe më shumë se 60% në sektorin e qymyrgurit, ndërsa në shumë sektorë të tjerë kostot e falimentimit luhaten në intervalin 20% – 30%.³⁸

³³ Bauweraerts, J. (2016); *Predicting bankruptcy in private firms: towards a stepwise regression procedure*; International Journal of Financial Research, Vol. 7, No. 2.; fq. 3

³⁴ Po aty

³⁵ Fernandez, G. (2012); *A comprehensive study of bankruptcy prediction: accounting ratios, market variables, and microstructure*; Florida International University; fq. 47

³⁶ LoPucki, L.; Doherty, J. (2004); *The Determinants of Professional Fees in Large Bankruptcy Reorganization Cases*; Journal of Empirical Legal Studies; fq. 112

³⁷ Po aty, fq. 132

³⁸ Reindl, J.; Stoughton, N.; Zechner, J. (2013); *Market implied costs of bankruptcy*; CFS Working paper; fq. 14

Sipas këtyre autorëve, industritë me barriera më të larta hyrjeje kanë kosto më të ulët të falimentimit, siç janë industria ushqimore, industria e duhanit, minierat, industria financiare, ndërsa kostot e falimentimit janë më të larta në sektorin e shërbimeve, të pajisjeve të biznesit dhe në sektorin e transportit.³⁹

Gjithashtu, njësitet ekonomike më të reja dhe më të vogla kanë rrezik më të lartë për të falimentuar. Nga rishikimi i literaturës për falimentimin në rajonin tonë, nuk jepen informacion në lidhje me saktësinë e klasifikimit të njësive ekonomike sipas këtij modeli. Në periudhën deri më vitet 90-ta të shekullit të kaluar ndërmarrjet tregtare të ne ishin shoqërore, ndërsa me procesin e privatizimit numër i madh i tyre falimentuan. Mbeti një pjesë e cila ka punuar mirë edhe paraprakisht, ndërsa sot janë moderne, me shtange dhe gondola, eskalatorë, me pajisje për klimatizim, me disa mënyra tjera që shfrytëzoheshin për të rregulluar shërbimet, etj.⁴⁰

3. Vështrimi historik

Ligjet moderne të falimentimit janë formuar në bazë të shumë zhvillimeve historike të dallueshme në këtë plan. Në ligjin e lashtë romak, një kreditor i papaguar gjykues ka mundur të sekuestrojë pasurinë e debitorit (*missio in bona*) dhe ta shes për të mirën e të gjithë kreditorëve (*venditio bonorum*). Procedimet e këtij lloji shkaktuan humbjen e të drejtave civile. Për të lehtësuar këtë vështirësi, një debitori iu dha privilegji të hiqte dorë vullnetarisht nga pasuria e tij duke bërë kërkesë tek një gjyqtar (*cessio bonorum*).⁴¹

Gjatë mesjetës pati zhvillime tjera në këtë drejtim. Qytetet mesjetare të Italisë miratuan statute që merreshin me mbledhjen dhe shpërndarjen e pasurive të

³⁹ Reindl, J.; Stoughton, N.; Zechner, J. (2013); *Market implied costs of bankruptcy*; CFS Working paper; fq. 14

⁴⁰ Demeska, L. (2010); *Ekonomia për vitin IV*; Shkup; fq. 191

⁴¹ <https://www.britannica.com/topic/bankruptcy> (Stefan Albrecht Riesenfeld, Contributor), viz. korrik, 2019

debitorëve, veçanërisht tregtarëve, të cilët kishin shkaktuar paaftësi paguese ose mashtruese.⁴²

Falimentuesit e tillë (rumpentes et falliti) i'u nënshtruan dënimeve të ashpra, dhe pasuritë e tyre u likuiduan. Për më tepër, ligji mesjetar spanjoll rivendosi cessio bonorum gjyqësor. Siete Partidas, një kodifikim i botuar nga autoriteti i Don Alfonso X i Urti, mbreti i Castile dhe León, gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XIII-të, përmbante dispozita të hollësishme në lidhje me debitorët e paaftë falimentues, të zbatueshme për tregtarët dhe jo-tregtarët njësoj, duke u dhënë mundësi atyre të sigurojnë një likuidim vullnetar të pasurive të tyre nën mbikëqyrjen gjyqësore. Një kreditor i papaguar mund të këmbëngulë ose në pagimin ose caktimin e pasurisë së tij nga debitori për të gjithë kreditorët.⁴³

Ligjet që merren me pasurinë e debitorëve gënjeshtarë dhe mashtrues, të modeluar pas statutit të qyteteve mesjetare italiane, u përhapën në Evropën perëndimore. Dispozitat e këtij lloji u miratuan në qendrat tregtare të Francës, Brabantit dhe Flanders gjatë shekujve XV dhe XVI. Zakonet e Antwerpit, të shtypura më 1582, përmbajnë rregulla gjithëpërfshirëse për trajtimin e falimentuesve dhe pronat e tyre.⁴⁴ Perandori Charles V, futi dispozita të rrepta për shtypjen e falimentimeve në Dekretin e tij për Administratën e Drejtësisë dhe Urdhrit të Mirë të 1531. Nuk mund të ketë dyshim që i pari akt anglez kundër personave që falimentonin, ishte i frymëzuar nga modelet evropiane veriore, pasi titulli riprodhon shprehjen flamaneze. Ai akt drejtonte procedurat e ngritura kundër debitorëve të pakujdesshëm ose të fshehur. Ai u zëvendësua nga një akt më i detajuar në vitin 1571 që zbatohet vetëm për tregtarët. Procedimet vullnetare nuk u parashikuan në Angli deri më 1844 e në Shtetet e Bashkuara deri në 1841.⁴⁵

Në Francë, rregullat kombëtare për falimentimin u futën në *Ordonnance du Commerce* të vitit 1673.⁴⁶ Me të rregulloheshin edhe detyrat vullnetare për përfitimin e

⁴² <https://www.britannica.com/topic/bankruptcy> (Stefan Albrecht Riesenfeld, Contributor), viz. korrik, 2019

⁴³ Po aty

⁴⁴ Po aty

⁴⁵ Po aty

⁴⁶ Po aty

kreditorëve të bërë nga tregtarët (Titulli X) edhe procedurat dhe efektet që rridhnin nga falimentimi (Titulli XI). Interpretohet në atë mënyrë që të kufizonte procedurat e falimentimit vetëm për tregtarët. Më pas edhe shumë vende të tjera ndiqnin këtë përvojë franceze në legjislacionin e tyre. Kështu, në Spanjë kufizimi i falimentimit ndaj tregtarëve u miratua nga Ordinancat e Bilbaos, të cilat u sanksionuan në 1737 dhe më pas u aplikuan në Amerikën Latine, veçanërisht Argjentinë.⁴⁷

Kufizimi i legjislacionit të falimentimit për personat e angazhuar në tregti krijoi një nevojë për procedurat e likuidimit të zbatueshme për debitorët e tjerë. Siç u përmend më lart, Siete Partidas përmbante provizione për procedurat vullnetare të likuidimit të zbatueshme për të gjitha klasat e debitorëve.⁴⁸

Mbi atë bazë, një jurist spanjoll i shekullit të 17-të, Salgado de Somoza, përpunoi rregulla të hollësishme për fillimin dhe zhvillimin e procedurave të likuidimit vullnetar, të cilat u quajtën "konkursi i kreditorëve". Trakti i tij, i quajtur *Labyrinthus Creditorum*, ndikoi në rrjedhën e ligjit spanjoll dhe gjithashtu pati ndikim të madh në ligjin e përbashkët të shteteve gjermane. Si rezultat, ligji spanjoll zhvilloi dy klasa të procedurave të likuidimit, një për tregtarët dhe një për jo-tregtarët. Ligji Spanjoll në këtë drejtim ishte modeli për legjislacionin në Portugali, Argjentinë, Brazil, dhe vendet e tjera të Amerikës Latine.⁴⁹

Kombet e tjera, përfshirë Austrinë, Gjermaninë, Anglinë, Shtetet e Bashkuara dhe kombet e ndikuara nga ligjet angleze, sollën si tregtarë ashtu edhe jo-tregtarë nën ligjet e tyre të falimentimit. Ligje më moderne në Amerikën Latine (p.sh: në Argjentinë dhe Peru) gjithashtu kanë krijuar një sistem të unifikuar. Franca, Italia dhe disa vende të Amerikës Latine, megjithatë, nuk ofrojnë procedura të vërteta falimentimi për debitorët e zakonshëm.⁵⁰

⁴⁷ <https://www.britannica.com/topic/bankruptcy> (Stefan Albrecht Riesenfeld, Contributor), viz. korrik, 2019

⁴⁸ Po aty

⁴⁹ Po aty

⁵⁰ Po aty

4. Shkaqet e inicimit të procedurës së falimentimit në vendin tonë, rajon dhe shtetet kryesore botërore⁵¹

MAQEDONIA E VERIUT	<i>Paaftësia paguese</i> – Në rastet kur një ndërmarrje nuk ka mundësi të shlyejë detyrimet e saj në një afat prej 60 ditëve nga data e maturimit. <i>Paaftësia paguese në një të ardhme të afërt</i> - kjo ka të bëjë në rastet kur një ndërmarrje parashikon se nuk do të mund të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit. <i>Mbingarkesa e tepërt financiare (borxhe)</i> – në rastet kur konstatohet se pasuritë e një ndërmarrjeje nuk mbulojnë të gjitha detyrimet që ka ndaj subjekteve tjera.
SHQIPËRIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit. <i>Paaftësia paguese në një të ardhme të afërt</i> - Kur njësia ekonomike parashikon se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit.
KOSOVA	<i>Paaftësia paguese</i> – Paaftësia e njësisë ekonomike për të përmbushur detyrimet në momentin e maturimit.
SHBA	<i>Paaftësia paguese</i> – Dështimi për të

⁵¹ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë, fq. 27

	shlyer detyrimet në datën e maturimit. Sipas Kodit të Falimentimit, "Paaftësia pague" është gjendja financiare, ku shumat e detyrimeve të njësisë ekonomike është më e madhe se vlera e tregut e aktiveve të saj.
MBRETËRIA E BASHKUAR	<i>Paaftësia pague</i> – Detyrimet tejkalojnë aktivet. <i>Mungesa e likuiditetit</i> – Pamundësia për të shlyer borxhet e maturuara gjatë aktivitetit të zakonshëm të njësisë ekonomike.
GJERMANIA	<i>Paaftësia pague</i> – Mbingarkesa me borxhe. <i>Mungesa e likuiditetit</i> – Pamundësia për të shlyer borxhet e maturuara gjatë aktivitetit të zakonshëm të njësisë ekonomike.
FRANCA	<i>Paaftësia pague</i> – Kur njësi ekonomike nuk përballon dot borxhet nëpërmjet aktiveve që ka në zotërim.
ITALIA	<i>Paaftësia pague</i> – Kur njësi ekonomike nuk është e aftë të shlyejë detyrimet e saj në kohën e duhur.
HOLANDA	<i>Paaftësia pague</i> – Kur njësi ekonomike ka ndërprerë shlyerjen e detyrimeve të saj.
ZVICRA	<i>Paaftësia pague</i> – Detyrimet tejkalojnë aktivet. <i>Mungesa e likuiditetit</i> – Dështimi për të shlyer një kreditor.

BELGIKA	<i>Paaftësia paguese</i> – Rënia e vlerës së kapitalit aksioner me 50%. <i>Mungesa e likuiditetit</i> – Pamundësia për të shlyer borxhet në kohën kur ato maturohen.
SPANJA	<i>Paaftësia paguese</i> – Njësia ekonomike nuk arrin të përmbushë rregullisht detyrimet e saj, edhe nëse zotëron aktive të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet e saj.
SUEDIA	<i>Paaftësia paguese</i> – Rënia e vlerës së kapitalit aksioner me 50%. <i>Mungesa e likuiditetit</i> – Pamundësia për të shlyer borxhet në kohën kur ato maturohen dhe kur kjo pamundësi nuk është e përkohshme.
ÇEKIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike ka të paktën dy kreditorë dhe nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet financiare brenda 30 ditëve nga data e maturimit të tyre. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur njësia ekonomike ka të paktën dy kreditorë dhe detyrimet tejkalojnë vlerën e aktiveve të saj.
SLLOVAKIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike ka të paktën dy detyrime ndaj të paktën dy kreditorëve dhe nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e tyre brenda 30 ditëve nga data e maturimit të tyre.

	<i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur njësia ekonomike ka të paktën dy kreditorë dhe vlera e detyrimeve të tyre tejkalon vlerën e aktiveve të njësisë ekonomike.
POLONIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet financiare në datën e maturimit ndaj të paktën dy kreditorëve. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se detyrimet e njësisë ekonomike tejkalojnë vlerën e aktiveve të saj.
RUSIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet financiare brenda 3 muajve nga data e maturimit të tyre. Në këtë rast, shuma e pretenduar duhet të jetë jo më pak se 300'000 rubla dhe pretendimi duhet të konfirmohet nga gjykata kompetente. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se detyrimet e njësisë ekonomike tejkalojnë vlerën e aktiveve të saj.
TURQIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se detyrimet e njësisë

	ekonomike tejkalojnë vlerën e aktiveve të saj. <i>Me kërkesë të kreditorit</i>, nëse debitori nuk ka një adresë të përhershme, është fshehur për të shmangur detyrimet ndaj kreditorit, është i përfshirë në praktika mashtrimi për të shkelur të drejtat e kreditorit, ka fshehur aktivet gjatë procedurave të ekzekutimit ose ka informuar kreditorin që detyrimi nuk do të shlyhet asnjëherë.
SLLOVENIA	<i>Paaftësia paguese</i> – Paaftësia e zgjatur e njësisë ekonomike për të paguar borxhet.
GREQIA	<i>Paaftësia paguese</i> – Situatë në të cilën detyrimet e njësisë ekonomike tejkalojnë aktivet dhe paaftësia e saj për të shlyer kreditorët.
BULLGARIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se pasuritë e njësisë ekonomike nuk mbulojnë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve.
RUMANIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj brenda 60 ditëve nga data e maturimit. <i>Paaftësia paguese në një të ardhme të</i>

	<i>afërt</i> – Kur njësia ekonomike parashikon se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit.
KROACIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj brenda 60 ditëve nga data e maturimit. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se pasuritë e njësisë ekonomike nuk mbulojnë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve dhe nëse njësia ekonomike parashikon se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit.
SËRRIA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj brenda 45 ditëve nga data e maturimit. <i>Paaftësia paguese në një të ardhme të afërt</i> – Kur njësia ekonomike parashikon se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se pasuritë e njësisë ekonomike nuk mbulojnë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve. <i>Dështimi në zbatimin e planit të miratuar të riorganizimit.</i>
MALI I ZI	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse

	njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj brenda 45 ditëve nga data e maturimit. <i>Mbingarkesa me borxhe</i> – Kur vërtetohet se pasuritë e njësive ekonomike nuk mbulojnë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve.
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	<i>Gjendja e paaftësisë paguese</i> – Nëse njësia ekonomike nuk është në gjendje të shlyejë detyrimet e saj brenda 30 ose 60 ditëve nga data e maturimit. <i>Paaftësia paguese në një të ardhme të afërt</i> – Kur njësia ekonomike parashikon se nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj në datën e maturimit.
KINA	<i>Paaftësia paguese</i> – Paaftësia e njësive ekonomike për të përmbushur detyrimet në momentin e maturimit.

Procedura e falimentimit mund të realizohet mbi pasurinë e secilit person juridik apo fizik i cili ka të regjistruar veprimtari të caktuar. Nga ana tjetër, procedura nuk mund të realizohet mbi pasurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mbi fondet që financohen nga Buxheti shtetëror, fondet e sigurimit pensional dhe invalidor apo atij shëndetësor, njësitë e vetadministrimit lokal dhe mbi organet dhe drejtoritë shtetërore.⁵²

Për një procedurë falimentimi si kompetente konsiderohet gjykata e cila gjendet në territorin e selisë së debitorit. Procedura falimentuese inicohet me anë të propozimit

⁵² Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 340-341

dhe është e karakterit urgjent dhe e njejta mund të inicohet nga kreditori, debitori ose personi tjetër i autorizuar me ligj në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara.⁵³

Paraprakisht kemi edhe procedurë paraprake e cila inicohet me qëllim që të verifikohet se a ekzistojnë shkaqet për të hapur një procedurë falimentuese.⁵⁴

Debitori e ka për detyrë t'i jap gjykatësit të gjitha informatat e duhura në lidhje me rastin konkret dhe poashtu është i detyruar t'i ndihmojë drejtorit të përkohshëm të falimentimit që i njëjti t'i pëmbush detyrimet e përcaktuara me ligj.⁵⁵

Duhet cekur se gjykatësi i falimentimit mund të emërtojë drejtorin e përkohshëm të falimentimit nga lista e drejtorëve të falimentimit që kanë fituar titull të tillë; të caktojë ndalesë të përgjithshme për disponim me pasurinë e debitorit ose të caktojë se i njëjti mund të disponojë me pasurinë e tij vetëm me leje paraprake të gjykatësit i cili është i caktuar për atë procedurë falimentimi; të ndalojë ose përkohësisht të shtyjë zbatimin e përmbarimit kundër debitorit, etj.⁵⁶

Pas marrjes së aktvendimit për inicim të procedurës, më së voni në afat prej 30 ditësh, gjykatësi i falimentimit thirr propozuesin, përfaqësuesit e debitorit falimentues dhe drejtorin e përkohshëm. Gjykatësi mundet që në afat prej 15 ditësh të caktojë ekspert i cili së bashku me drejtorin e përkohshëm do të përcaktojë se debitori a është i paaftë për pagesë. Pas kësaj gjykatësi i falimentimit nxjerr aktvendim për hapjen e procedurës ose refuzim të së njëjtës në afat jo më shumë se 3 ditë pas përfundimit të seancës.⁵⁷

Këtu duhet cekur edhe atë që njihet si masë falimentuese e cila përfshin pasurinë e përgjithshme të debitorit në ditën e hapjes së procedurës si dhe pasurinë që ai do ta fitojë gjatë procedurës së falimentimit. Në këtë masë nuk hyjnë sendet dhe të drejtat e debitorit mbi të cilat nuk do të mund të zbatohet përmbarim nëse debitori nuk ka qenë tregtar apo zejtar.⁵⁸

⁵³ Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 341, 356

⁵⁴ Po aty, fq. 356

⁵⁵ Po aty, fq. 357

⁵⁶ Po aty, fq. 358

⁵⁷ Po aty, fq. 359

⁵⁸ Po aty, fq. 362

Si kreditor të falimentimit konsiderohen kreditorët personal të debitorit falimentues, kërkesat e të cilëve kategorizohen në radhë më të larta e më të ulta pagesore. Kur bëhet pagesa e tyre duhet zbatuar dy parime, atë të ekskluzivitetit që domethënë se kreditorët e rendit më të ulët përmbushin kërkesat pas atyre të rendit më të lartë, dhe parimi i barabarësisë në kuadër të një rendi të njëjtë pages. ⁵⁹

Kreditori i cili duke u bazuar në të drejtën e tij reale ose personale argumenton se një send nuk është pjesë e masës falimentuese, i njëjti konsiderohet si kreditor i përjashtuar. ⁶⁰

5. Trajtimi juridik i falimentimit në shtetet e sistemit anglosakson

5.1 Trajtimi juridik i falimentimit në SHBA

Falimentimi është një ligj federal që u jep individëve dhe bizneseve një mundësi për të eliminuar ose riorganizuar borxhin e rëndë në rast se ata nuk janë në gjendje ta paguajnë atë sipas kushteve paraprakisht të përcaktuara ose orarit konkret për një kredi ose lëshimit të detyrimeve. Por nga lindi kjo ide? Falimentimi para themelimit të kësaj Amerike që njohim sot sigurisht që ishte diçka në mendjen e themeluesve në kohën e Luftës Revolucionare. Në vazhdim do të bëjmë një vështrim të shkurtër të historisë së falimentimit në Sh.B.A.. ⁶¹

Falimentimi në Shtetet e Bashkuara ka pasur një histori të gjatë dhe të larmishme. Fillimisht, kornizat e Kushtetutës u përpoqën të modelojnë ligjet e falimentimit sipas ligjit të përbashkët anglez në lidhje me këtë temë. Sidoqoftë, që nga themelimi i Sh.B.A., ligji ka marrë shumë kthesa të njëpasnjëshme. ⁶²

Fermerët ishin ata që vunë në të vërtetë bazat për ligjet e falimentimit në vetë Kushtetutën e Sh.B.A.. Kjo dispozitë mund të gjendet në nenin I, seksioni 8, i cili i jep Kongresit fuqinë që të krijojë ligje uniforme mbi temën e falimentimit në të gjithë

⁵⁹ Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 371

⁶⁰ Po aty, fq. 372

⁶¹ <https://www.thebalance.com/history-of-bankruptcy-in-the-united-states-316225> (David Hynes, Contributor), viz, qershor, 2019

⁶² Po aty

Shtetet e Bashkuara. Sidoqoftë, Kongresi nuk veproi menjëherë bazuar në atë fuqi. U deshën më shumë se dhjetë vite pasi Kushtetuta u ratifikua para se Kongresi të sillte çështjen e falimentimit. Ndërkohë, disa shtete kishin krijuar sistemin e tyre shumë të gjërë të falimentimit në mungesë të një kornize uniforme mbarëkombëtare. Në fakt, shumë prej këtyre sistemeve ishin shumë pro-kreditor dhe parashikonin burgimin e debitorëve. U desh të pritet deri në vitin 1833 nën ligjin federal dhe për disa shtete deri në vitin 1849 para se burgimet e debitorit të shfuqizoheshin zyrtarisht.⁶³

Më 1800, Kongresi miratoi ligjin e parë federativ në lidhje me falimentimin, të quajtur Akti i Falimentimit i 1800. Ngjashëm me shumë sisteme të falimentimit shtetëror në atë kohë, Akti i Falimentimit i 1800 ishte i orientuar nga kreditorët dhe lejonte vetëm falimentimet e pavullnetshme të debitorëve tregtarë. Nuk kishte dispozita që individët të paraqisnin vetë. Disa debitorë dinakë kuptuan se mund të kërkonin nga një kreditor miqësor të fillonte çështjen e falimentimit. Sidoqoftë, për shkak të shumë ankesave për korrupsion dhe favorizim, ligji u shfuqizua vetëm tre vjet më vonë. Shtetet vazhduan të drejtojnë sisteme të ndryshme falimentimi në mungesë të një ligji federal.⁶⁴

Pas panikut financiar të vitit 1837, Kongresi miratoi një ligj tjetër të falimentimit, të quajtur Akti i Falimentimit i 1841. Për herë të parë, ky ligj i falimentimit lejoi që debitorët të paraqisnin kërkesen për falimentim vullnetar pa pasur nevojë që një kreditor të kërkojë të njëjtën. Ky ishte një revolucion në ligjin e falimentimit. Në fakt, një debitor mund të paraqiste falimentim dhe të merrte një shkarkim të borxhit. Për më tepër, çdo individ mund të ishte debitor, jo vetëm një tregtar, siç parashikohej në ligjin e vitit 1800. Fuqia për të lejuar shkarkimin dhe për të gjykuar çështje të tjera që lidhen me falimentimin, qëndroi në Gjykatat e Qarkut të Shteteve të Bashkuara. Sidoqoftë, për fat të keq, kreditorët e shikuan ligjin e vitit 1841 si sigurim të paktë për pagesën e kreditorëve dhe shkarkimin e shumë borxheve për shumë debitor. Prandaj, ligji i vitit 1841 u shfuqizua në 1843.⁶⁵

⁶³ <https://www.thebalance.com/history-of-bankruptcy-in-the-united-states-316225> (David Hynes, Contributor), viz. qershor, 2019

⁶⁴ Po aty

⁶⁵ Po aty

Pas një paniku tjetër financiar dhe Luftës Civile të Sh.B.A-së, Kongresi vendosi të provojë përsëri duke miratuar Aktin e Falimentimit të 1867. Akti i vitit 1867 ishte shumë i detajuar dhe përfshinte një sërë situatash. Ky ligj ishte i pari që lejonte falimentime të pavullnetshme për çdo individ, jo vetëm tregtarë. Gjykatave të Qarkut të Shteteve të Bashkuara u kërkohet të caktonin një "regjistër falimentimi" në kryerjen e detyrave që lidhen me falimentimin. Fatkeqësisht, ky ligj dështoi në vitin 1888 nën të njëjtat kritika që i'u bënë ligjeve të mëparshme federale të falimentimit.⁶⁶

Vetëm në vitin 1898, Kongresi për herë të parë miratoi një ligj gjithëpërfshirës të falimentimit, i cili u bë, në thelb, i përhershëm. Me miratimin e Aktit të Falimentimit të 1898, megjithëse është ndryshuar dhe zëvendësuar shumë herë, nuk ka pasur periudha të mëtejshme të shfuqizimit dhe / ose periudha kur qeveria federale nuk kishte ligje falimentimi në fuqi.⁶⁷

Pas disa ndryshimeve të ligjit të 1898, Kongresi miratoi Aktin e Reformës së Falimentimit të vitit 1978. Ky ligj bëri ndryshime gjithëpërfshirëse në sistemin e falimentimit. Ky ligj solli në fuqi atë që njihet si "Kodi i Falimentimit". Ky ligj bëri disa ndryshime, duke rritur në mënyrë drastike shtrirjen e fuqisë së gjyqtarëve të falimentimit.⁶⁸

Akti i Reformës së Falimentimit i vitit 1978 u ndryshua përsëri me miratimin e Aktit të Parandalimit të Abuzimit të Falimentimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të vitit 2005, BAPCPA ishte rezultati i viteve të studimit mbi mënyrën më të mirë për të reformuar sistemin e falimentimit, dhe prezantoi Testin e Synimit për përcaktimin se cili nga debitorët individualë mund të kualifikohen për Kapitullin 7 dhe cilët duhet të paraqesin një çështje të Kapitullit 13 për të marrë ndonjë lehtësim. BAPCPA gjithashtu prezantoi këshilla të detyrueshme për këshillim kredie dhe kurse të detyrueshme të edukimit të debitorit.⁶⁹

⁶⁶ <https://www.thebalance.com/history-of-bankruptcy-in-the-united-states-316225> (David Hynes, Contributor), viz. qershor, 2019

⁶⁷ Po aty

⁶⁸ Po aty

⁶⁹ Po aty

Ka qenë një luftë e vazhdueshme midis interesave të ndryshme, kryesisht atyre të kreditorëve dhe debitorëve. Edhe pse ka shumë ndryshime të tjera para dhe pas këtij ligji të vitit 2005, këto janë pikat kryesore në historinë e falimentimit në Shtetet e Bashkuara.⁷⁰

5.2 Trajtimi juridik i falimentimit në Mbretërinë e Bashkuar

Falimentimi në Mbretërinë e Bashkuar është i ndarë në regjime të veçanta lokale për Anglinë dhe Uellsin, për Irlandën Veriore dhe Skocinë. Ekziston gjithashtu një ligj për falimentim në Mbretërinë e Bashkuar që zbatohet në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, pasi falimentimi i referohet vetëm falimentimit të individëve dhe partneriteteve. Procedurat e tjera, për shembull administrimi dhe likuidimi, vlejnë për kompanitë e falimentimit.⁷¹

Në Angli dhe Uells, falimentimi drejtohet nga Pjesa IX e Aktit të Falimentimit 1986 dhe nga Rregullat e Falimentimit 1986. Termi falimentim vlen vetëm për individët, jo për kompanitë ose personat e tjerë juridikë. Një individ mund të falimentojë vetëm me urdhër të gjykatës pas paraqitjes së një peticioni(kërkesë) për falimentim. Një individ mund të paraqesë kërkesën e tij me arsyetimin se ai është josolvent, d.m.th. i paafte për të paguar borxhet e tij. Poashtu, një kreditor ose më shumë kreditorë gjithashtu mund të bëjnë kërkesë për falimentim kundër një debitori individual.⁷²

Para se një kreditor të paraqesë një peticion falimentimi, ai duhet së pari të dorëzojë tek debitori një kërkesë ligjore në një nga format e përcaktuara që i kërkon debitorit të paguajë shumën e kërkuar brenda 21 ditëve nga data e shërbimit të kërkesës. Debitori mund të bëjë kërkesë në gjykatë për të lënë mënjane kërkesën në bazë të faktit se borxhi është diskutuar mbi baza të besimit ose se ai ka një kundërpadi, të ngritur ose të një kërkesës ndërlidhëse cila është e barabartë ose e tejkalon shumën e borxhit të kërkuar nga kreditori.⁷³ Nëse debitori nuk arrin të paguajë shumën e kërkuar

⁷⁰ <https://www.thebalance.com/history-of-bankruptcy-in-the-united-states-316225> (David Hynes, Contributor), viz. qershor, 2019

⁷¹ <https://www.gov.uk/statutory-demands>, viz. korrik, 2019

⁷² Po aty

⁷³ Po aty

në kërkesë ose të aplikojë për të lënë mënjatë kërkesën ose nëse kërkesa e tij për të lënë mënjatë kërkesën hidhet poshtë nga gjykata, kreditori mund të paraqesë një kërkesë falimentimi. Përndryshe, një kreditor mund të bëjë petition pa e paraqitur më parë kërkesën nëse ekzekutimi në aktgjykim ka dështuar. Në të dy rastet, debitori duhet t'i detyrohet kreditorit të paktën 5000 funta dhe kërkesa duhet të jetë për një shumë të likuiduar, d.m.th. një shumë fikse e parave.⁷⁴

Një kërkesë falimentimi duhet t'i shërbehet personalisht debitorit, por nëse kreditori nuk është në gjendje të kryejë shërbimin, qoftë sepse debitori ka shmangur shërbimin ose nuk mund të gjurmohet, gjykata mund të urdhërojë shërbim të zëvendësuar, d.m.th. shërbim me postë ose ndonjë metodë tjetër e cila ka të ngjarë të sjellë kërkesën në vëmendjen e debitorit. Në dëgjimin e petitionit gjykata mund të kërkojë një urdhër falimentimi nëse borxhi është i padiskutueshëm ose nuk mund të kundërshtohet, të rrëzojë petitionin (për shembull nëse borxhi është paguar) ose të shtyjë kërkesën për t'i dhënë debitorit kohë për të paguar.⁷⁵

Nëse bëhet një urdhër falimentimi, administrimi i punëve të një personi të falimentuar trajtohet nga një i besuar në falimentim i cili duhet të jetë ose një nënpunës civil ose një praktikues i licensuar i falimentimit që ndryshe quhet drejtor falimentues i caktuar qoftë nga Sekretari i Shtetit ose nga kreditorët në një mbledhje të thirrur për atë qëllim. Drejtori falimentues është përfaqësues i debitorit falimentues dhe në procedurën falimentuese ai do të veprojë në emër dhe llogari të debitorit falimentues. Masa falimentuese (duke përfshirë mjetet e tregtisë së tij dhe të sendeve të tjera) i jepet personit të besuar i cili është i detyruar t'i realizojë ato kërkesa (përgjithësisht duke i shitur ato) për të paguar borxhin ndaj kreditorëve.⁷⁶

⁷⁴ <https://www.gov.uk/statutory-demands>, viz. korrik, 2019

⁷⁵ Po aty

⁷⁶ Grier WS, Nicholas (2014), *Bankruptcy in Scotland: Past, Present, and Future*, Scottish Parliamentary Review, Vol. I, No. 2, fq. 132

6. Trajtimi juridik i falimentimit në shtetet e sistemit kontinental evropian

Secili shtet, siç u pa edhe nga tabela më lartë, ka trajtim të veçantë të falimentimit, edhe pse mund të ekzistojnë ngjashmëri. Një numër i shteteve më të mëdha të cilat kanë shoqëri tregtare më të mëdha e kanë sofistikuar legjislacionin që merret me falimentimin, riorganizimin dhe likuidimin, madje disa prej tyre bëjnë shqyrtimin e këtyre duke formuar edhe gjykata speciale, kryesisht për çështje të tilla. Duhet cekur se në kontinentin tonë falimentimi trajtohet në nivel qendror. Këtu mund të përmendim Holandën, Ligji për falimentimin udhëhiqet nga Kodi Holandez i Falimentimit(Faillissementswet). Ky kod mbulon tre procedura të veçanta ligjore. E para është falimentimi (Faillissement). Qëllimi i falimentimit është likuidimi i aseteve të shoqërisë tregtare. Falimentimi vlen për individët dhe shoqëritë tregtare. Procedura e dytë ligjore në Faillissementswet është "Surseance". "Surseance" vlen vetëm për shoqëritë tregtare. Qëllimi i saj është të arrijë marrëveshje me kreditorët e shoqërisë tregtare. Procedura e tretë është "Schuldsanering". Kjo ka për qëllim vetëm individët e caktuar.⁷⁷

Nga ana tjetër, në Mbretërinë e Bashkuar, falimentimi ka të bëjë vetëm me individët dhe ortakëritë. Shoqëritë tregtare dhe korporatat tjera i nënshtrohen procedurave josolvente juridike të quajtura në mënyrë të ndryshme: likuidimi dhe administrimi (urdhëri i administrimit dhe administratori i kontrolluar). Megjithatë, termi "falimentim" përdoret shpesh kur shoqëritë përmenden në media ose në biseda të përgjithshme. E sa i përket dukurisë së falimentimit në Skoci, atje ajo njihet me termin sekuestrim, duke konsideruar procedurën dhe atë që ngërthen e njejta. Akti i Falimentimit 1966 është legjislacioni që rregullon falimentimin në Australi. Vetëm individët mund të falimentojnë, ndërsa shoqëritë tregtare jo falimentuese hyjnë në likuidim dhe administrim.⁷⁸

Ligji zviceran, nga ana tjetër, falimentimin e konsideron si pasojë e josolvencës. Kjo paraqet një formë të procedurave për detyrimin e ekzekutimit të borxhit e

⁷⁷ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 59

⁷⁸ Po aty

urdhëruar nga gjykata që në përgjithësi vlen vetëm për subjektet e regjistruara tregtare. Në falimentim, të gjitha asetet e debitorit likuidohen nën administrimin e kreditorëve, edhe pse ligji lejon mundësinë e ristrukturimit të borxheve në mënyrë të ngjashme sikurse në Kapitullin e 11 të Kodit të SHBA-ve për Falimentim.⁷⁹

Tabela e mëposhtme ofron të dhënat e ndërmarrjeve të falimentuara në Evropën Perëndimore ku reflektohet rimëkëmbja ekonomike e cila pësoj krizën financiare që kaploi botën.

Vendi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Austria	6'657	6'194	6'266	5'626	5'600	5'422
Belgjika	9'570	10'224	10'578	11'739	10'736	9'762
Danimarka	6'461	5'468	5'456	4'993	4'049	4'029
Finlanda	2'864	2'944	2'956	3'131	2'954	2'574
Franca	51'060	49'506	59'556	60'980	60'548	61'379
Gjermania	32'060	30'120	28'720	26'120	24'030	23'180
Greqia	355	445	415	392	330	189
Irlanda	1'525	1'638	1'684	1'365	1'164	1'049
Italia	10'089	10'844	12'311	14'272	16'101	16'015
Luksemburgu	918	961	1,033	1,016	845	873
Hollanda	7'211	6'176	7'373	8'375	6'645	5'271
Norvegjia	4'435	4'355	3'814	4'564	4'803	4'462
Portugalia	5'144	6'077	7'763	8'131	7'200	7'288
Spanja	4'845	5'910	7'799	8'934	6'392	4'916
Suedia	7'546	7'229	7'737	7'701	7'158	6'432
Zvicra	6'255	6'661	6'841	6'495	5'867	6'098
Mbretëria e Bashkuar	17'468	22'175	21'252	18'935	17'660	15'952
Gjithsej	174'463	176'927	191'563	192'769	182'132	174'891
Eurozona ²	138'045	135'322	150'665	154'750	147'649	


Tabela 2-Numani,E.(2017);*Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*;

Tiranë;fq.60

Sipas këtyre të dhënave (Tabela 2), njësitë ekonomike të falimentuara gjatë vitit 2015 janë reduktuar me 7241 ose rreth 4% në krahasim me vitin e mëparshëm. Kjo paraqet vitin e dytë radhazi ku hasim në një përmirësim të dukshëm përse i përket situatës së paaftësisë paguese të njësive ekonomike duke filluar nga viti 2010. Por, me

⁷⁹ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 59

gjithë përmirësimin e situatës ekonomike të vendeve të Europës Perëndimore, numri i njësive ekonomike të falimentuara në vitin 2015 është ndjeshëm më i lartë se numri i tyre i regjistruar përpara fillimit të krizës financiare (në vitin 2007 numri ishte 130'910). Gjithashtu, i njëjti trend vërehet edhe përsa i përket Eurozonës (Grafiku 1).⁸⁰



Grafiku 1- Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq.60

Në vazhdim (Grafiku 2) është paraqitur lëvizja e numrit të njësive ekonomike të falimentuara për disa vende të Evropës Perëndimore për një periudhë gjashtë vjeçare (2010 - 2015). Këtu shohim se nga vendet e Evropës Perëndimore vetëm Gjermania, Danimarka dhe Austria duket të kenë rënie në numrin e ndërmarrjeve që mund të konsiderohen si të paafta nga pikëpamja paguese, nga ku shihet se Danimarka ka shënuar një rënie më të ndjeshme (37.6%), duke u pasuar nga Gjermania (27.7%) dhe më në fund Austria (18.5%).⁸¹ Nga ana tjetër, shtetet si Spanja, Portugalia, Finlanda dhe Belgjika kanë shënuar një rritje të numrit të ndërmarrjeve të tilla deri në vitin 2013 dhe më pas kanë hasur në rënie të dukshme, me siguri si rrjedhojë e përmirësimit të situatës ekonomike në ato vende. Reduktimi i numrit të ndërmarrjeve me probleme pagesore, në Mbretërinë e Bashkuar, Greqi dhe Irlandë ka filluar më shpejt, që në vitin 2011. Këtu më së shumti befason situata në Francë dhe Itali, ku shohim se numri i ndërmarrjeve me

⁸⁰ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 60

⁸¹ Po aty

probleme pagesore vazhdon të rritet, dhe ate në periudhën gjashtë vjeçare në Itali (58.7%) kurse në Francë (20.2%). Kjo rritje mund të shpjegohet nga mungesa e besimit nga ana e biznesit, paqëndrueshmëria e nivelit të prodhimit industrial, si dhe nga pasiguria ekonomike e këtyre vendeve.⁸²



Grafiku 3- Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*;

Tiranë; fq. 62

Mund të vërejmë se kontributi i vendeve të Beneluksit ka mbetur i qëndrueshëm përgjatë 6 viteve të përfshira në studim. Përsa i përket vendeve skandinave, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar, Austrisë dhe Zvicrës, kontributi i tyre në numrin total të njësive

⁸² Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 61

ekonomike që ndodhen në situatën e paaftësisë paguese ka pësuar rënie, ku rënia më e madhe është rregjistruar në Gjermani, me 5.1%. Përsa i përket Francës, kontributi i saj në numrin total të njësive ekonomike të Europës Perëndimore që ndodhen në paaftësi paguese ka ardhur duke u rritur që nga viti 2011. Në vitin 2015, Franca është përgjegjëse për falimentimin e më shumë se 1/3 e njësive ekonomike të kësaj pjese të Europës (35.1%). Nga ana tjetër, kontributi i vendeve që kanë probleme me borxhin publik (Greqia, Irlanda, Italia, Portugalia dhe Spanja) është rritur në mënyrë të ndjeshme, nga 12.6% në vitin 2010 në 16.8% në vitin 2015.⁸³

6.1 Trajtimi juridik i falimentimit në Shqipëri dhe Kosovë

Duhet cekur se në Shqipëri nuk ka të dhëna që mund të konsiderohen si zyrtare për të gjitha qarqet në lidhje me falimentimin e njësive ekonomike. Pra, nuk ekziston asnjë qendër e cila do të bënte mbledhjen e informacioneve të tilla. Për më tepër, nuk ka asnjë tregues i cili të masë shkallën e mbylljes së njësive ekonomike për shkak të vështirësive financiare që mund t'i kenë ato.⁸⁴ Të vetmet statistika që disponohen janë ato të mbledhura nga INSTAT, të cilat raportojnë numrin e njësive ekonomike aktive dhe të njësive ekonomike të reja të krijuara, si dhe të dhënat që disponohen nga 20 gjykatat e rretheve gjyqësore në lidhje me kërkesat për hapjen e procedurave të falimentimit të njësive ekonomike. Në këtë mënyrë, ne jemi në gjendje të llogarisim numrin e njësive ekonomike të mbyllura, por gjithsesi, nuk jemi në gjendje të marrim një informacion mbi arsyet e mbylljes së tyre.⁸⁵ Duke ditur se një njësi ekonomike mund të mbyllë aktivitetin e saj edhe për shkak të shumë arsyeve të tjera (shpesh arsye që nuk kanë të bëjnë me vështirësitë financiare, si p.sh, arritja e qëllimit për të cilën ishte krijuar, vendimi i ortakëve, përfundimi i afatit të funksionimit të parashikuar në statut dhe në kontratën e themelimit, largimi nga zona gjeografike, shkrirja apo blerja nga një shoqëri tjetër, etj), mund të themi se këto statistika nuk janë përfaqësuese të normës së vërtetë të falimentimit të njësive ekonomike në Shqipëri. Megjithatë, në kushtet kur nuk mund të

⁸³ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 62

⁸⁴ Po aty, fq. 66

⁸⁵ Po aty

sigurohen të dhëna të tjera, do të përqëndrohemi në vijim në statistikat mbi njësitë ekonomike aktive dhe shkallën e lindshmërisë së njësive ekonomike në Shqipëri, si dhe të dhënat në lidhje me kërkesat për hapjen e procedurave të falimentimit të njësive ekonomike.⁸⁶

Sipas asaj që u cek, kërkesat për hapjen e procedurave të falimentimit shqyrtohen nga gjykata e rrethit ku njësia ekonomike ka zyrat qendrore apo ushtron aktivitetin e saj. Për të nxjerrë të dhënat e përgjithshme në lidhje me numrin e kërkesave për hapjen e procedurave të falimentimit është mbledhur informacion nga 20 gjykatat e rretheve gjyqësore të vendit. Në vijim jepet numri total i kërkesave të mbartura dhe kërkesave të reja për hapjen e procedurave të falimentimit të njësive ekonomike, të paraqitura në gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse.⁸⁷

Numri i kërkesave të mbartura është më i lartë se numri i kërkesave të reja në vitet e shqyrtuara, për shkak të zgjatjes së kohës së shqyrtimit të çështjeve nga gjykatat përtej afateve të përcaktuara në ligjin mbi falimentim të RSH. Vetëm në vitin 2009 dhe 2015 numri i kërkesave të reja është më i lartë se numri i kërkesave të mbartura. Në vitin 2009 kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të ndryshimeve në vitin paraardhës në ligjin mbi falimentim, ndryshime të cilat e lehtësuan disi procedurën e falimentimit, ndërsa në vitin 2015 numri i kërkesave të reja më të larta se ato të mbartura mund t'i atribuohet nismës së ndërmarrë nga Ministria e Financave kundër informalitetit të ekonomisë. Ajo që ia vlen të përmendet është fakti që numri më i lartë i kërkesave të paraqitura në gjykatë për hapjen e procedurave të falimentimit është shënuar në vitin 2013, i cili ishte një vit elektorale që u shoqërua me ndryshime politike dhe që i parapriu ndryshimeve në sistemin tatimor të vendit.⁸⁸

Nga ana tjetër, Kosova është në tranzicion ekonomik dhe një ligj i mirë për falimentim është thelbësor për të ndihmuar shoqëritë tregtare dhe ndërmarrësit në përpjekjet e tyre, sidomos gjatë periudhave të vështira ekonomike. Ekzistenca e një ligji të mirë për falimentimin dhe e sistemit funksional për zbatimin e tij (përfshirë edhe

⁸⁶ Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësive ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë; fq. 67

⁸⁷ Po aty

⁸⁸ Po aty

gjykatat funksionale) janë qenësore për funksionimin e duhur të veprimtarisë afariste në ekonominë e tregut. Me të vërtetë, ligjet e mira për falimentimin e inkurajojnë ndërmarrësinë, sepse ju ofrojnë rrjet të sigurt njerëzve të cilët duan të bëjnë afarizëm.⁸⁹

Lirisht mund të themi se mungesa e ligjeve për falimentim ose nëse ato nuk janë funksionale mund të dëmtojnë ekonominë e vendit. Për shembull, në Kosovë ekziston një prirje për të mos parashtruar kërkesë për falimentim, por në vend të saj të mbyllen dyert e ndonjë shoqërie tregtare dhe të hapet një e re nën emër të ri, duke mos u paguar kreditorëve asnjë shumë për borxhet të cilat ju detyrohen atyre. Shumë ekspertë thonë se ligji i cili trajtohet në këto module ka nevojë për shumë akte nënligjore në mënyrë që ai të funksionojë në mënyrë të duhur. Në mungesë të tyre, zbatimi i tij do të ishte i vështirë. Në këtë mënyrë, është në interes të Kosovës të përfundojë kornizën ligjore që ka të bëjë me falimentimin dhe të fillojë zbatimi i saj në gjykata dhe autoritete tjera që merren me veprimtari afariste.⁹⁰

Ligji për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim të RK i ka këto qëllime:

- Në masë të duhur të mbështes zhvillimin e një ekonomie të shëndoshë të tregut kosovar;
- Ligji i falimentimit me gjitha dispozitat e tija të rregullojnë procedurat për likuidim;
- Të mbështesë ndërmarrjet;
- Të ndikojë pozitivisht për investime të huaja;
- Të ndikojë edhe për investime të brendshme.⁹¹

Ligji për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim të RK “definon kushtet dhe procedurat për likuidim apo riorganizim të personave juridik në falimentim dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet për palët që marrin pjesë apo që janë të prekura nga një procedurë e tillë”.⁹²

⁸⁹ USAID – broshurë (2014); *Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial*; Prishtinë; fq. 14

⁹⁰ Po aty

⁹¹ Po aty

⁹² Po aty

Ai poashtu ofron udhëzime adekuate në lidhje me aktet tjera të cilat duhet të miratohen në mënyrë që ligji të funksionojë në mënyrën e duhur dhe për çka është i synuar.⁹³

Sidoqoftë, këtu mund të përmendim se ligji në fjalë ka një të metë që ka të bëjë me pjesën ku hasim në një paqartësi në lidhje me likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim është neni i cili e përshkruan fushëveprimin e tij. Neni 1.2. thotë “Ky ligj qeveris falimentimin e personave juridik, që përfshin ortakërinë e përgjithshme, ortakërinë e kufizuar, dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar”. Megjithatë, Ligji për Shoqëritë Tregtare të RK i njeh vetëm shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si persona juridik, kurse shoqëritë kolektive dhe shoqëritë komandite nuk i konsideron si persona juridik. Si i tillë, Neni 1.2. i Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim të RK është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare të RK.⁹⁴

Me të vërtetë është i pasaktë në shënimin e tij se termi “persona juridik” përfshin shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Kjo problematikë duhet të zgjidhet përmes ndryshimit të ligjit në një periudhë në të ardhmen dhe të ndryshohet titulli dhe fushëveprimi i tij, në mënyrë që të përfshijë të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.⁹⁵ Megjithatë, duhet të merret parasysh se Ligji për riorganizimin dhe likuidimin e personave juridik në falimentim nuk vlen për:

- Ndërmarrjet private;
- Kompanitë e Sigurimit;
- Institucionet financiare (p.sh. bankat);
- Ofruesit e pensioneve; dhe
- Ndërmarrjet publike dhe shoqërore, të cilat akoma nuk janë shndërruar në subjekte ligjore.⁹⁶

⁹³ USAID – broshurë (2014); *Programi për përmbardim dhe legjislacion komercial*; Prishtinë; fq. 15

⁹⁴ Po aty

⁹⁵ Po aty, fq. 16

⁹⁶ Po aty

Përfshirja e “ndërmarrjeve private” nga fushëveprimi i këtij ligji është një pjesë tjetër e cila krijon probleme, sepse ajo përfshihet ndoshta të gjitha shoqëritë tregtare të cilat ky ligj synon t’i mbulojë. Parashikimi është se me përfshirjen e “ndërmarrjeve private”, ky ligj synon të përfshijë ndërmarrjet individuale, të përcaktuara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare të RK. Edhe pse kjo është njëra prej mangësive të shumta të cilat duhet të përmirësohen në mënyrë që ky ligj të jetë funksional, ne do të vazhdojmë me verzionin ekzistues dhe shpresojmë se amendamentet e mëvonshme do të përmirësojnë problemet e përmendura.⁹⁷

⁹⁷ USAID – broshurë (2014); *Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial*; Prishtinë; fq. 16

KREU II

FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR-ASPEKTI MATERIAL

1. Kuptimi

Falimentimi me element të huaj paraqet falimentimin ndërkombëtar. Elementi i huaj mund të jetë i lidhur për elementet më të rëndësishme në një procedurë falimentuese si: pasuria e debitorit falimentues dhe pjesmarrësit në procedurën e falimentimit.⁹⁸ Siç u cek më parë, sapo të fillon procedura e falimentimit dhe të emërohet administratori, e tërë pasuria mbetet në administrimin e administratorit dhe shoqëria tregtare në falimentim nuk ka asnjë të drejtë të menaxhojë pasurinë e saj. Pasuria e shoqërisë tregtare në falimentim quhet “masa falimentuese”. Regjistrimi i kërkesës krijon masën falimentuese dhe ajo përbëhet prej tërë pasurisë së debitorit prej datës së parashtrimit të kërkesës, si dhe e tërë pasuria e mbledhur nga administratori në emër të debitorit gjatë procedurës ose rrjedhjes së zakonshme të afarizmit. Masa falimentuese përfshin, por nuk kufizohet në:

- gjithë pasurinë e luajtshme, të paluajtshme, materiale dhe jomateriale, kudo që gjendet, qoftë në administrim të debitorit ose të personave të tretë
- kërkesat dhe veprimet juridike të debitorit kundër personave të tretë;
- fitimet nga veprimet që përfshijnë të ardhurat që arkëtohen prej transfereve të pandershme apo të privileguara;
- trashëgimet dhe fondet tjera të pranuar brenda gjashtë (6) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës;
- qiradhënien, të ardhurat dhe fitimet që dalin prej përdorimit të pronësisë së pasurisë ose nga veprimet e biznesit të debitorit; dhe
- të drejtat kontraktuese, liçencat, ose të drejtat tjera të përcaktuara me dispozitat në fuqi.⁹⁹

⁹⁸ Jashari, A (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq 415

⁹⁹ USAID – broshurë (2014); *Programi për përmbardim dhe legjislacion komercial*; Prishtinë; fq. 30

2. Shkaqet materiale për trajtimin e falimentimit ndërkombëtar

2.1. Pasuria e debitorit falimentues dhe pjesëmarrësit

Së pari, performanca e një njësie ekonomike ndikohet nga faktorë të jashtëm, faktorë të cilët nuk varen nga drejtimi i njësisë ekonomike. Norma e rritjes ekonomike, norma e inflacionit, kursi i këmbimit, norma e interesit, preferencat, sjellja konsumatore janë disa nga faktorët e jashtëm që ndikojnë në performancën e njësisë ekonomike.¹⁰⁰

Mjetet e disponueshme të debitorit të falimentimit të ndërmarra midis datës së hapjes së procedurës së huaj të falimentimit dhe datës së shpalljes së vendimit për dhënien e pëlqimit për pranim të vendimit të falimentimit të huaj në bordin e njoftimeve në gjykatë, sipas nenit 334 paragrafi (4) të Ligjit për falimentim të RMV do të humbasin efektin e tyre juridik nëse janë në kundërshtim me interesat e kreditorëve të debitorit të falimentimit dhe nëse vërtetohet se pala kundërshtare ka ditur ose duhet ta ketë ditur, në momentin e disponueshmërisë të debitorit të falimentimit, se kundër tij, jashtë vendit është ngritur procedura e falimentimit. Pala kundërshtare ka të drejtën e një kundërpadie nga pasuria e falimentimit nëse rrit vlerën e masës falimentuese. Nëse mjetet në disponim të debitorit të falimentimit janë fituar pas shpalljes së propozimit për njohje në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në zbatim të nenit 332 paragrafi (1) të këtij ligji, konsiderohet se pala kundërshtare e dinte ose duhej ta dinte se në momentin e posedimit të mjeteve të debitorit të falimentimit, ndaj tij është hapur një procedurë falimentimi jashtë vendit. Dispozitat e tilla mund të kundërshtohen sipas legjislacionit të shtetit.¹⁰¹

¹⁰⁰ Sharma, S.; Mahajan, V. (1980); *Early Warning Indicators of Business Failure*; Journal of Marketing; fq.82

¹⁰¹ Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, nenet, 332 – 334 (p. 1-4 dhe 1-5)

FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR-ASPEKTI PROCEDURAL

1. Kuptimi

Bashkëpunimi ndërkufitar e dimë se kryhet përmes aplikimit të rregullativave të Bashkimit Evropian, të cilat doemos duhet të pranohen në procesin e përafrimit. Pra, është e dobishme që të njëjtat të theksohen. Duhet cekur se baza ligjore për bashkëpunimin e jurisprudencës në Bashkimin Evropian është përfshirë në nenin 81 paragrafi 1 të tekstit të spastruar të Marrëveshjes për funksionimin e Bashkimit Evropian, Protokolli nr. 20 dhe 21 i Traktatit të Lisbonës.¹⁰²

Kur kemi të bëjmë me përcaktimin e gjykatës kompetente, njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve dhe vendimeve në lëndët jashtëgjyqësore duhet potencuar se instrumenti kryesor është Urdhëresa e Këshillit nr. 44/2001 për kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në kontestet civile dhe tregtare. Urdhëresa në fjalë ofron krijimin e kushteve për harmonizimin e rregullave për konfliktin e kompetencave brenda shteteve-anëtare, si dhe të thjeshtëzohet dhe përshejtohet njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të cilat janë miratuar në kontestet civile dhe tregtare.¹⁰³

Urdhëresa e lartpërmendur është plotësuar me Urdhëresën e Këshillit (EC) nr. 2201/2003 nga data 27 Nëntor i vitit 2003 në lidhje me kompetencën, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në lëndët martesore dhe në lëndët e përgjegjësisë prindërore. Me qëllim të lehtësimit të arkëtimit ndërkombëtar të borxheve në lidhje me përkujdesjen, Këshilli e miratoi Urdhëresën nr. 4/2009 në të cilën në një instrument juridik i bashkoi të gjitha aktet e kompetencës gjyqësore, të drejtës meritore, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, si dhe bashkëpunimin e organeve kompetente kombëtare.¹⁰⁴

¹⁰² Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë* ; Shkup; fq. 4

¹⁰³ Po aty

¹⁰⁴ Po aty

Me Urdhëresën nr. 805 /2004 është inkorporuar Urdhëri Evropian për ekzekutimin e kërkesave të pakontestueshme. Urdhëresa nr. 650/2012 e Parlamentit dhe Këshillit ka për qëllim shfuqizimin e të gjitha rekomandimeve me të cilat ballafaqohen qytetarët gjatë gëzimit të të drejtave të tyre që kanë të bëjnë me trashëgiminë ndërkombëtare. Sa i përket pjesës për përmirësimin e qasjes në kontestet ndërkombëtare, Këshilli e miratoi Direktivën nr. 2003/8/EC me të cilën përcaktohen rregullat e përbashkëta minimale për ndihmën e jurisprudencës. Qëllimi i kësaj direktive është të garantohet një shkallë e caktuar e ndihmës juridike në kontestet ndërkufitare për çdo person i cili nuk posedon mjete të nevojshme.¹⁰⁵

Kur kemi të bëjmë me lehtësimin e qasjes së shoqërive dhe qytetarëve evropian në drejtim të jurisprudencës si dhe ta bëjë më efikas, Bashkimi Evropian inkorporoi rregulla të përbashkëta të veprimit dhe përshpejtimin të zgjidhjes së kontesteve ndërkufitare në lidhje me kërkesa më pak të rëndësishme, si dhe kthimin ndërkufitar të kërkesave të pakontestueshme monetare për mbarë rajonin e Unionit. Këtu gjithsesi se flitet për Urdhëresën (EC) nr. 861/2007 për inkorporimin e kontesteve evropiane me vlerë të vogël dhe për Urdhëresën (EC) nr. 1896/2006 për inkorporimin e urdhërpagesës evropiane. Këtu kemi të bëjmë me procedura të cilat nuk janë të detyrueshme, sa u përket procedurave të parashikuara me legjislacionet kombëtare.¹⁰⁶

Poashtu, duhet të theksohet se ekziston edhe një instrument për thjeshtëzimin e bashkëpunimit në lëndët civile, dhe ky është zhvillimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në administratën e jurisprudencës. Projekt ky i cili ka filluar në vitin 2007 dhe është shndërruar në strategji evropiane në rajonin e e-jurispudencës. Instrumentet e e-jurispudencës janë: vendosja e portalit evropian të e-jurispudencës, ndërlidhja e ndërsjellë të evidencave penale në nivel evropian, përdorimi më i madh i video-konferencave gjatë procedurave gjyqësore, përkthimi automatik, formularët e rrjetit dinamik, si dhe baza evropiane e përkthyesve dhe interpretuesve gjyqësor. Gjithashtu, edhe pasqyra vjetore e situatës në jurisdiksonin e

¹⁰⁵ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 5

¹⁰⁶ Po aty

jurisprudencës së Bashkimit Evropian është një mekanizëm informativ i Komisionit për ndihmën e BE dhe shteteve-anëtare për arritjen e përbërjes më cilësore të jurisprudencës përmes mundësisë të të dhënave objektive, të sakta dhe komparative për cilësinë dhe efikasitetin e sistemit të jurisprudencës të të gjitha shteteve-anëtare.¹⁰⁷

Sa u përket procedurave të falimentimit, në Evropë aktualisht është në fuqi Rregullorja e Bashkimit Evropian për procedurat në rastet e insolvencës 1346/2000. Në të vërtetë bëhet fjalë për njërën nga rregulloret më të plota të së drejtës ndërkombëtare të insolvencës. Kjo rregullore hyri në fuqi më 31 Maj 2002 dhe pati influencë të madhe mbi kuadrin ligjor të falimentimit, si dhe mbi shtetet të cilat e fituan statutin e kandidatit për inkuadrim në BE. Sa u përket vendeve të Evropës Juglindore, një kontribut të madh për stimulimin e këtij bashkëpunimi pritet të ofroj formimi i Rrjetit të Institucioneve për trajnimin e gjyqtarëve në Evropën Juglindore, i cili u formua në muajin Prill të vitit 2016, ndërsa Këshilli Rajonal për Bashkëpunim e mori rolin kryesor në kuadër të Rrjetit për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Qendra e Informacioneve për takime, punëtori dhe seminare rajonale për trajnimin e përfaqësuesve të institucioneve të jurisprudencës.¹⁰⁸

Veprimi i gjykatave gjatë zbatimit të procedurave ndërkufitare për falimentim, transferim dhe bashkim, si dhe për çështje tjera të rëndësishme për zhvillimin ndërkufitar të biznesit është rregulluar me ligjet e RMV. Ligjet bazike të cilët e rregullojnë këtë materie janë: Ligji për shoqëri tregtare i RMV, Ligji për transferimin e shoqërive tregtare i RMV, Ligji për falimentim i RMV, Ligji për përmbarim i RMV dhe aktet nënligjore të cilat burojnë nga të njëjtit. Nga analiza e kornizës ligjore për falimentim në RMV mund të konkludojmë se ekziston kornizë ligjore për falimentimin ndërkufitar, e njëjta është plotësisht e harmonizuar me Urdhëresën e Bashkimit Evropian. Në Ligjin për falimentim i cili në Republikën e Maqedonisë së Veriut aktualisht është në fuqi është parashikuar kapitull i veçantë me titull "Falimentimi ndërkombëtar". Në këtë pjesë të ligjit janë parashikuar rregullat nga e ashtuquajtura e Drejta

¹⁰⁷ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 6

¹⁰⁸ Po aty

ndërkombëtare e cila është njëra nga fushat më komplekse dhe më të vështira juridike që në vetvete përfshinë më shumë veprime të ndryshme procesuale, materiale dhe veprime juridike në kolizion.¹⁰⁹

2. Kompetenca në bazë të pasurisë së debitorit të huaj falimentues

Personi i vendosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili është debitor i debitorit të huaj të falimentimit, është i detyruar, menjëherë pasi të mësojë procedurën e falimentimit jashtë vendit, ta informojë debitorin e huaj të falimentimit për ekzistencën e detyrimit të tij dhe për momentit e ekzistences së atij detyrimi. Personi i tillë është i autorizuar të përmbushë detyrimin e tij të drejtpërdrejtë ndaj debitorit të falimentimit të huaj, nëse kanë kaluar tetë ditë nga dita e dërgimit të njoftimit tek administruesi i huaj i falimentimit, dhe gjykata e Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në atë moment, në përputhje me nenin 331 paragrafi (1) të këtij ligji, nuk ka specifikuar ndonjë masë sigurie ose të ketë caktuar një kujdestar të përkohshëm të falimentimit. Kostot eventuale të vonimit të përmbushjes së detyrimeve të duhura konsiderohen si shpenzime të pasurisë së falimentimit. Nëse detyrimi është përmbushur drejtpërdrejt ndaj debitorit të huaj të falimentimit ndërmjet ditës së hapjes së procedurës së falimentimit të huaj dhe ditës së publikimit të saj, vendimin për njohjen e vendimit të falimentimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit në bordin e njoftimeve në gjykatë, sipas nenit 334 paragrafi (4) të këtij ligji, dhe pa njoftuar të besuarin e huaj për ekzistencën e detyrimit të tillë, personi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk do të lirohet nga detyrimi i tij nëse vërtetohet se në momentin e përmbushjes direkte të detyrimit të debitorit të huaj falimentues e dinte ose duhej ta dinte se ndaj tij ishte hapur një procedurë falimentimi. Nëse detyrimi është përmbushur drejtpërdrejt ndaj debitorit të huaj të falimentimit pas publikimit të njoftimit për propozimin për njohje në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në përputhje me

¹⁰⁹ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 7

nenin 332 paragrafi (1) të këtij ligji, debitori i debitorit të falimentimit konsiderohet se e dinte ose duhej ta dinte se kundër tij ishte ngritur një procedurë falimentimi.¹¹⁰

3. Zbatimi i parimit *lex fori* në procedurën e falimentimit

Përndryshe, historiku i procedurës së falimentimit me element të huaj fillon me atë që një numër i caktuar i shteteve e kanë pranuar parimin e territorialitetit. Sipas këtij parimi procedurës së falimentimit të hapur në një shtet tjetër nuk duhet t'i njihen pasojat juridike në shtete të tjera. Ky parim me vite të tëra ka funksionuar në skenën juridike, kështu që shumë shtete në legjislacionin e tyre të falimentimit fare nuk i kanë trajtuar dispozitat e falimentimit ndërkombëtar. Përveç tjerash duhet të theksohet se baza e nënkuptimit të së drejtës së këtillë të parimit të territorialitetit është në atë që vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit paraqet akt të sovranitetit të shtetit i cili e ka hapur procedurën e falimentimit dhe së këtejmi, pasojat juridike të atij vendimi nuk mund të vlejné jashtë kufijve të atij shteti. Mes tjerash, parimi i territorialitetit në vetvete e ngërthen edhe një dimension tjetër, i cili korrespondon me mbrojtjen e kreditorëve vendor nga mangësitë, përkatësisht të metat e procedurës së falimentimit e cila është hapur në një shtet të huaj. Deri në njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit mund të vinte vetëm në kuadër të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ndërkombëtare vetëm nëse është garantuar njohja e ndërsjellë e procedurave të falimentimit midis shteteve anëtare të asaj marrëveshje.¹¹¹

Në të drejtën ndërkombëtare insolvente (falimentuese) ekzistojnë dy sisteme të njohjes së vendimeve të huaja për hapjen e procedurës së falimentimit. Njëri sistem parashikon njohje automatike të vendimit të huaj për hapjen e procedurës së

¹¹⁰ Ligji për falimentim i RMV, (2006 - 2014) "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, neni 331, 332, 334

¹¹¹ Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 416

falimentimit. Ky sistem i njohjes është parashikuar me Rregulloren e Bashkimit Evropian.¹¹²

Sistemi i dytë i njohjes së vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit është përmbushja e supozimeve të përcaktuara me ligj në mënyrë që të njihet vendimi i huaj për hapjen e procedurës së falimentimit, të cilat shqyrtohen në procedurë të veçantë formale. Për këtë sistem është përcaktuar edhe e drejta maqedonase. Secili shtet ka interes që vetëm gjykata e saj mund t'i zgjidh marrëdhëniet e caktuara në rastet e ekzistencës së një procedure falimentuese. Gjykata e Maqedonisë së Veriut është ekskluzivisht kompetente për zbatimin e procedurës së falimentimit kundër debitorit të falimentimit selia e të cilit është në territorin e saj. Në rastet kur njësia afariste e debitorit falimentues nuk gjendet në Maqedoninë e Veriut, por aty gjendet vetëm pasuria e tij, atëherë procedura e falimentimit në vendin tonë ka mundësi të hapet vetëm në ato raste kur:

- Në shtetin në të cilin debitori i falimentimit e ka veprimtarinë afariste kryesore procedura kundër tij nuk mund të hapet për shkak të kushteve të parapara në bazë të së drejtës së falimentimit të atij vendi;
- Sipas së drejtës së shtetit ku gjendet veprimtaria kryesore, procedura do ta përshijë vetëm pasurinë e debitorit të falimentimit në atë vend;
- Hapja e procedurës së falimentimit në Maqedoninë e Veriut propozohet për shkak të insolventit të trashëgimtarit;
- Hapja e procedurës së veçantë të falimentimit në Maqedoninë e Veriut propozohet në suazat e procedurës për pranimin e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit.¹¹³

Me teorinë dhe praktikën gjyqësore mbisundon qëndrimi sipas të cilit cilësimi duhet të bëhet sipas LEX FORI, përkatësisht sipas të drejtës së shtetit para të cilit shtrohet çështja dhe sipas normave të kolizionit të shtetit të cilat shërbejnë si piknisje për zgjidhjen e kontestit.¹¹⁴ Cilësimi sipas ligjit të gjykatës para së cilës shtrohet çështja

¹¹² Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 416

¹¹³ Po aty

¹¹⁴ Bilalli, A.; Kuçi, H. (2012); *E drejta ndërkomtare private*, Prishtinë; fq 157

(LEX FORI) arsyetohet me faktin se gjatë cilësimit shtrohet çështja e të kuptuarit të drejtë të normës së kolizionit. Kurse norma e kolizionit juridikisht mund të sqarohet dhe të kuptohet brenda sistemit juridik që i takon, që në rastin konkret është ligji i gjykatës brenda së cilës shtrohet çështja.¹¹⁵

KREU III

SUPOZIMET DHE PRANIMI I VENDIMEVE TË HUAJA PËR HAPJEN E PROCEDURËS FALIMENTUESE

Për pranimin e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit në menyrë përkatëse zbatohen rregullat e përgjithshme të së drejtes së RMV për pranimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Propozimi për pranimin e vendimit të huaj parashtrohet pranë gjyqit në territorin e të cilit gjendet njësia afariste e debitorit të falimentimit në RMV, ndërsa nëse debitori i falimentimit nuk ka njësi afariste në Maqedoninë e Veriut, pranë gjyqit në territorin ku gjendet pasuria ose pjesë e pasurisë së debitorit të falimentimit. Nëse debitori i falimentimit ka njësi afariste në territore të gjykatave të ndryshme ose nëse pasuria e tij gjendet në territorin e gjykatave të ndryshme, për marrjen e vendimit për pranim, kompetente është gjykata të cilës së pari i është parashtruar propozimi për hapjen e procedurës së falimentimit.¹¹⁶

Propozim për pranimin e vendimit të gjykatës së huaj ose të organit tjetër kompetent për hapjen e procedurës së falimentimit mund të parashtrojë drejtori i huaj i falimentimit ose kreditori i debitorit të falimentimit.¹¹⁷

Propozimin për pranimin e vendimit të huaj, gjykata do ta refuzojë nëse për shkak të kundërshtimit të debitorit të falimentimit ose të ndonjë pjesëmarrësi tjetër në procedurën, konstaton se debitori të falimentimit aktin me të cilin procedura është

¹¹⁵ Bilalli, A.; Kuçi, H. (2012); *E drejta ndërkomtare private*, Prishtinë; fq 157

¹¹⁶ Jashari, A (2012); *E drejta afariste (statusore)*; Tetovë; fq 417

¹¹⁷ Po aty; fq 418

ngritur nuk i është dorëzuar në përputhje me të drejtën e shtetit në të cilin është marrë vendimi dhe nëse në atë procedurë janë cenuar të drejtat e tij themelore.¹¹⁸

Pas parashtrimit të propozimit për pranimin të vendimit të huaj, gjykata mund të përcaktojë masa sigurie, përkatësisht të emërojë drejtor të përkohshëm të falimentimit. Pas pranimit të propozimit për pranimin e vendimit të huaj, gjykata do të shpall atë në “Gazetën zyrtare të RMV” dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Propozimin e tillë gjykata do t’ia dërgojë debitorit të huaj të falimentimit, drejtorit të huaj të falimentimit dhe kreditorëve.¹¹⁹

Të drejtë ankese kundër vendimit për pranimin e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit kanë debitori i huaj i falimentimit, drejtori i huaj i falimentimit dhe kreditorët.¹²⁰

Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar disa marrëveshje me disa shtete, duke u bazuar në konventat evropiane nga fusha e ndihmës juridike ndërkombëtare, për lëndët civile, në mesin e të cilëve shumica janë vende të EJT si Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Bullgaria, Mali i Zi, Kroacia, Kosova, Rumania, Ukraina, Sllovenia, Serbia dhe Turqia.

- Marrëveshje midis qeverisë maqedonase dhe qeverisë shqiptare për ndihmë juridike në lëndët civile dhe; Marrëveshja midis qeverisë maqedonase dhe midis qeverisë shqiptare për ekstradim, ka hyrë në fuqi me datë 02.10.1998; Marrëveshje midis qeverisë maqedonase dhe qeverisë shqiptare për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore për lëndët penale, ka hyrë në fuqi me datë 02.10.1998.¹²¹
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinës për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale, ka hyrë në fuqi me datë 06.01.2006; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinës për ekstradim; Marrëveshje midis Republikës së

¹¹⁸ Jashari, A (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq 418

¹¹⁹ Po aty

¹²⁰ Po aty, fq 419

¹²¹ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.16/98

Maqedonisë së Veriut dhe Bosnjë e Hercegovinës për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në materien penale.¹²²

- Marrëveshje për ndihmë juridike në lëndët civile midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, ka hyrë në fuqi me datë 07.04.2002.¹²³
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë dhe Malit të Zi për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale.
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi për ekstradim, ka hyrë në fuqi me datë 17.07.2012.¹²⁴
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kroacisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në materien penale, ka hyrë në fuqi me datë 26.05.1995; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kroacisë për ndihmë juridike në lëndët civile dhe penale, ka hyrë në fuqi me datë 26.05.1995; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kroacisë për ekstradim, ka hyrë në fuqi me datë 22.11.2012.¹²⁵
- Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në lëndët penale, ka hyrë në fuqi me datë 24.06.2012; Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ekstradim, ka hyrë në fuqi me datë 24.06.2012; Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar, ka hyrë në fuqi me datë 24.06.2012.¹²⁶

¹²² “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.59/06

¹²³ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.10/02

¹²⁴ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.77/04, 13/2012

¹²⁵ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.17/95, 19/95, 57/2012

¹²⁶ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.178/2011

- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Rumanisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në lëndët civile, ka hyrë në fuqi me datë 10.03.2007.¹²⁷
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ukrainës për ndihmë juridike në lëndë civile, ka hyrë në fuqi me datë 20.06.2003.¹²⁸
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Sllovenisë në lëndët civile dhe penale, ka hyrë në fuqi me datë 05.09.1997.¹²⁹
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Sllovenisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në lëndët penale, ka hyrë në fuqi me datë 05.09.1997.
- Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Sllovenisë për ekstradim, ka hyrë në fuqi me datë 05.09.1997; Marrëveshje midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Sllovenisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në lëndët penale, ka hyrë në fuqi me datë 05.09.1997.¹³⁰
- Marrëveshje për bashkëpunim juridik në lëndët civile dhe penale midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Turqisë, ka hyrë në fuqi 28.07.2000.¹³¹

1. Zbatimi i së drejtës kompetente

Duhet cekur se Ligji për shoqëritë tregtare i RMV i rregullon çështjet e bashkimit, bashkëngjijtjes dhe ndarjes së shoqërive. Kjo duhet të nënkuptojë se i njëjti nuk bën dallime midis shoqërive me kapital vendor dhe të huaj. Nëse shoqëria funksionon në Republikën e Maqedonisë së Veriut ajo duhet të themelohet konform Ligjit për shoqëri tregtare të RMV dhe ta respektojë legjislacionin e atij vendi. Këto dispozita janë me

¹²⁷ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.41/04

¹²⁸ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.48/00

¹²⁹ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.24/96

¹³⁰ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.24/96

¹³¹ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.23/97

konotacion miqësor ndaj bizneseve të cilët funksionojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.¹³²

Transferimi i shoqërive tregtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut rregullohet me Ligjin për transferimin e shoqërive tregtare “Gazeta Zyrtare e RMV” numër 69/13, 188/13, 166/14, 154/15 dhe 23/16. Me këtë ligj rregullohen mënyra, kushtet dhe procedurat e transferimit të shoqërive aksionare, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedurën e transferimit dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e procedurës së transferimit të shoqërive aksionare. Dispozitat e ligjit zbatohen ndaj letrave me vlerë të cilat listohen në bursën e autorizuar të letrave me vlerë të lëshuara nga shoqëritë aksionare me obligime të veçanta për raportime, konform Ligjit për letra me vlerë, ndërsa nuk zbatohen gjatë blerjes së aksioneve në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Esenca e ligjit është në dispozitës ku thekson se asnjë person, i vetëm ose bashkë me persona me të cilët vepron bashkërisht, nuk guxon të fitojë më shumë se 25% të letrave me vlerë me të drejtë vote të lëshuara nga një shoqëri e caktuar aksionare pa dhënë ofertë paraprake për transferim. Ofertuesi në ofertë obligohet se do t'i blejë të gjitha aksionet e shoqërisë brenda një periudhe të caktuar dhe sipas çmimit të caktuar i cili nuk guxon të jetë më i ulët nga çmimi më i lartë sipas të cilit transferuesi tanimë ka blerë aksione në 12 muajt e fundit para njoftimit për qëllimin e transferimit, ose më të ulët nga çmimi mesatar i arritur në një bursë të autorizuar, ose në lartësinë e vlerës së çmuar të letrave me vlerë të përcaktuar nga ana e vlerësuesit të autorizuar.¹³³

Synimi i ligjit është të mbrohen aksionerët jodominant dhe ata mund t'i shesin aksionet e tyre në shoqërinë e cila transferohet, me çmim identik të atij sipas të cilit është transferuar shumica e aksioneve të ndonjë shoqërie. Përveç kësaj, qëllimi i këtij ligji është të përcaktohet procedura konform të cilës do të zbatohet transferimi dhe sipas së cilës të gjitha palët e interesuara do të informohen dhe do të mund ta japin mendimin e tyre në lidhje me transferimin. Sa i përket qëllimit të tij për transferim, transferuesi e njofton Komisionin e letrave me vlerë, organin administrues të shoqërisë,

¹³² Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 6

¹³³ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 7

Bursën e autorizuar dhe Komisionin për mbrojtjen e Konkurrencës, ndërsa qëllimin e publikon menjëherë pas njoftimit, përkatësisht pas dhënies së pëlqimit nga Komisioni i letrave me vlerë. Njoftohen edhe të punësuarit. Në ofertën përcaktohet edhe numri i aksioneve të cilat janë të nevojshme të blihen në mënyrë që të llogaritet se oferta për transferim është e suksesshme. Në afat prej 10 ditësh nga publikimi i ofertës për transferim, organi i administrimit të shoqërisë duhet të ofroj mendim në lidhje me ofertën për transferim.¹³⁴

Në këtë mendim mund të përfshihen edhe qëndrimet e të punësuarve, nëse ekzistojnë të këtillë. Afati i vlefshmërisë së ofertës së transferimit është 60 ditë nga publikimi. Brenda këtyre 60 ditëve ka mundësi të ketë oferta konkurrencte nga më shumë ofertues. Suksesi ose mosesuksesi i ofertës përcaktohet pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së ofertës. Ligji e përcakton mënyrën dhe procedurën e kalimit të aksioneve të shitura tek transferuesi. Komisioni i letrave me vlerë e kontrollon rrjedhën dhe zbatimin e procedurës së transferimit.¹³⁵ Ligji nuk ka dispozita të veçanta për transferimin ndërkufitar, megjithatë, duke e pasur parasysh faktin se ofertues mund të jetë çdo person fizik ose juridik, vendor ose i huaj, të gjithë ata janë të barazuar me dispozitat e këtij ligji që të marrin pjesë të barabartë në procesin e transferimit të shoqërive. Për dallim nga legjislacioni paraprak, me Ligjin për falimentim të Republikës së Maqedonisë Veriore që ka hyrë në fuqi në vitin 2006, falimentimit ndërkombëtar ligjvënës i ka përkushtuar vëmendje më të madhe dhe janë përcaktuar më shumë dispozita me të cilat në mënyrë të detajuar trajtohet kjo procedurë në krahasim me legjislacionin e deriatëhershëm, ndërkaq nën ndikimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe të UNCITRAL (United Nations Commission on International Trade Law), model i ligjit për insolvencën ndërkufitare. Së këtijmi, qëllimi i këtij modeli të ligjit i cili i lë hapësirë shtetit tërësisht ta transponojnë ose të ndryshojnë ndonjë dispozitë nuk është ta harmonizojë të drejtën e falimentimit të shteteve.¹³⁶ Qëllimi është shumë më i kufizuar dhe më i fokusuar, para së gjithash në drejtim të stimulimit të bashkëpunimit

¹³⁴ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 6

¹³⁵ Po aty

¹³⁶ Po aty

midis gjykatave dhe organeve të tjera të shteteve në rastin e falimentimit ndërkufitar, realizimi i sigurisë më të madhe juridike për tregti dhe investime, administrimi i ndershëm dhe efikas në rastin e falimentimit ndërkufitar, si dhe mbrojtja e interesave të të gjithë kreditorëve dhe personave të tjerë të interesuar, duke e përfshirë edhe debitorin, mbrojtjen dhe maksimizimin e vlerës së pronës së debitorit, si dhe lehtësimi dhe shpëtimi i shoqërive problematike financiare me mbrojtjen e investimeve dhe vendeve të punës.¹³⁷

2. Propozimi për njohjen

Karakteristikë e të drejtës sonë falimentuese është rregullimi i çështjes së njohjes së vendimit të huaj gjyqësor. Në Ligjin për falimentim të RMV, dispozita e cila e rregullon njohjen e vendimit gjyqësor të huaj e vë në dukje zbatimin e rregullave të përgjithshme të së drejtës në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat kanë të bëjnë me njohjen e vendimeve të huaja gjyqësore. Kjo çështje është rregulluar në të drejtën ndërkombëtare private. Vendimi i huaj gjyqësor barazohet me vendimin e gjykatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe prodhon veprim juridik në Republikën e Maqedonisë vetëm nëse e aprovon gjykata e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Kushtet për njohjen

Me vendim të huaj gjyqësor konsiderohet vendimi i gjykatës së një shteti të huaj. Përndryshe, objekt i njohjes mund të jetë jo vetëm vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit i miratuar nga një gjykatë e huaj por edhe vendimet të cilat janë miratuar në kuadër të procedurës së hapur të falimentimit, me qëllim që procedura e falimentimit të zbatohet dhe të përfundohet. Një vendim i këtillë mund të jetë edhe vendimi i miratuar nga ana e gjykatës së huaj për shkarkimin e drejtorit të huaj të

¹³⁷ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 6

falimentimit, vendimi për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të bordit të kreditorëve, vendimi për miratimin e planit të propozuar për riorganizim dhe ngjashëm. Gjithashtu, objekt i njohjes mund të jenë edhe vendimet e miratuara jashtë procedurës së falimentimit, të cilat janë në korrelacion të ngushtë me procedurën e hapur të falimentimit dhe kanë të bëjnë me masën e falimentimit dhe përmbushjen e kërkesave të kreditorëve. Kështu që objekt i njohjes mund të jenë vendimet e miratuara nga ana e gjykatës kontestimore me të cilët përcaktohet kërkesa e caktuar e kreditorit, vendimi i gjykatës në lidhje me padinë e paraqitur për përgënjeshttrimin e veprimeve juridike të debitorit të falimentimit si dhe vendimi i gjykatës kontestimore që ka të bëjë me ndonjë marrëveshje të lidhur para hapjes së procedurës së falimentimit. Krahas vendimeve të cilat janë miratuar gjatë procedurës së hapur të falimentimit, objekt i përgënjeshttrimit mund të jenë edhe vendimet e miratuara në procedurën paraprake në të cilat bëjnë pjesë vendimi për përcaktimin e masave të sigurimit. Gjyqtari i falimentimit është ai i cili duhet të vendos për aprovimin e vendimit të huaj gjyqësor, si dhe për hapjen e procedurës së falimentimit, ndërsa gjykatat kompetente të cilat duhet të vendosin për propozimin e paraqitur për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor në bazë të të cilit ndaj debitorit të falimentimit jashtë vendit është hapur procedurë falimentimi, janë gjykatat me kompetencë të zgjeruar. Propozim për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, përkatësisht vendim nga një organ tjetër kompetent për hapjen e procedurës së falimentimit mund të paraqes drejtori i huaj i falimentimit dhe kreditorët e debitorit të falimentimit. Nëse njihet aktvendimi për hapjen e procedurës së falimentimit atëherë konsiderohet se është hapur procedurë falimentimi mbi pronën e debitorit të falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.¹³⁸

¹³⁸ Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, nenet 331, 332, 333 dhe 334

4. Procedura për njohjen e vendimit të huaj

Procedura e njohjes së vendimit të huaj gjyqësor fillon me paraqitjen e propozimit. Gjykata me kompetencë territoriale e cila duhet të vendos për propozimin sa i përket njohjes së vendimit të huaj gjyqësor është gjykata në territorin e të cilës gjendet filiali i debitorit të falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në rast se debitori i falimentimit nuk ka themeluar filial, kompetencë territoriale do të ketë gjykata në rajonin e të cilës gjendet prona ose një pjesë e pronës në pronësi të debitorit të falimentimit mbi të cilën kërkohet të hapet procedura e falimentimit. Nëse debitori i falimentimit ka më shumë filiale në territorin e gjykatave të ndryshme ose prona gjendet në territorin e më shumë gjykatave, kompetencë territoriale do të ketë gjykata të cilës fillimisht i është paraqitur propozimi për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit. Rregulli i tretë që ka të bëjë me përcaktimin e kompetencës territoriale të gjykatës e cila duhet të vendos për propozimin e paraqitur për njohjen e vendimit të huaj ka të bëjë me rastin kur prona përbëhet nga kërkesa. Në këtë rast gjykatë me kompetencë territoriale që të vendos sipas propozimit për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit është gjykata në territorin e së cilës debitorët e falimentimit kanë selit e tyre, përkatësisht vendqëndrimin.¹³⁹

Së këtejmi, vendimi gjyqësor i huaj nuk do të njihet nëse: vendimi i huaj gjyqësor nuk do të bashkëngjitet në origjinal ose në kopje e vërtetuar bashkë me vërtetimin nga gjykata kompetente e huaj, përkatësisht nga një organ tjetër për plotfuqishmërinë e vendimit sipas së drejtës së shtetit në të cilin është miratuar; nëse nuk paraqitet përkthim i vërtetuar të vendimit të huaj gjyqësor në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në atë gjykatë, nëse origjinali i vendimit të huaj gjyqësor ose kopja e tij e vërtetuar nuk janë përpiluar në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar në atë gjykatë tek e cila hapet procedura për njohjen e atij vendimi; nuk do të paraqitet edhe vërtetim për ekzekutimin e vendimit sipas së drejtës së shtetit në të cilin është miratuar, nëse me

¹³⁹ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë* ;Shkup; fq. 7

kërkesën për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor kërkohet edhe njohja e aspektit ekzekutiv të tij, paraqitësi i kërkesës për njohjen e atij vendimi të huaj gjyqësor; nëse njëra nga palët dëshmon se për shkak të parregullshmërive të procedurës, nuk mund t'i shfaq instrumentet e veta të mbrojtjes; nëse njëra nga palët dëshmon se thirrja, padia ose aktvendimi me të cilin është hapur procedura nuk janë paraqitur në mënyrë të parashikuar me të drejtën e shtetit në të cilin është miratuar vendimi, përkatësisht fare nuk ka pasur përpjekje për dërgesën e këtillë, përveç nëse në ndonjë mënyrë është përfshirë në diskutimin për çështjen kryesore në procedurën e shkallës së parë; nëse në çështjen në fjalë ekziston kompetencë e jashtëzakonshme e gjykatës ose të organit tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut; nëse për çështjen e njëjtë gjykata ose ndonjë organ tjetër i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar vendim të plotfuqishëm ose nëse në Republikën e Maqedonisë është njohur ndonjë vendim tjetër i huaj gjyqësor që është miratuar në lidhje me çështjen e njëjtë; nëse veprimi i njohjes së tij është në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.¹⁴⁰

5. Vlefshmëria e vendimit të huaj të pranuar për hapjen e procedurës së falimentimit

Në mënyrë që gjykata kompetente të veprojë sipas propozimit të paraqitur për njohjen e vendimit të huaj gjyqësor si ndaj një propozimi të rregullt bashkë me atë duhet të paraqiten edhe provat si vijojnë: vendimi i huaj gjyqësor në origjinal ose kopje e vërtetuar, me përkthim në gjuhën maqedonase i vërtetuar nga përkthyesi i autorizuar; vërtetim nga gjykata e huaj kompetente përkatësisht e organit për aspektin e ekzekutimit të vendimit; regjistrim të pronës së njohur të debitorit të falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe regjistrim të kreditorëve të tij me prova përkatëse. Supozime të cilat në mënyrë kumulative duhet të plotësohen për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit janë: vendimi të jetë miratuar

¹⁴⁰ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 8

nga gjykata, përkatësisht organi, i cili sipas të drejtës së Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetent për zgjidhjen e lëndëve me elemente ndërkombëtare; Me fjalë të tjera, nuk do të njihet vendimi i gjykatës së huaj në rast se ekziston kompetencë e jashtëzakonshme e gjykatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vendimi të jetë i ekzekutueshëm sipas të drejtës së shtetit në të cilin është miratuar, madje edhe nëse nuk është i plotfuqishëm; njohja e vendimit të mos jetë në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut; të ekzistoj ndërvarësi, përkatësisht reciprocitet.¹⁴¹

6. Njohja e vendimit të huaj në rast të hapjes paraprake të procedurës falimentuese në Maqedoninë e Veriut

Vendimi i huaj për hapjen e një procedure falimentimi që plotëson prezumimin e njohjes nga neni 330 i Ligjit për falimentim të RMV *(ku thuhet se vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit do të pranohet nëse: vendimi është marrë nga ana e gjyqit, gjegjësisht organit i cili sipas së drejtës së RMV është kompetent për zgjidhjen e rasteve të lëndëve me elemente ndërkombëtare; vendimi është ekzekutiv sipas së drejtës së vendit ku është sjellur vendimi, edhe nëse i njëjti nuk është i plotfuqishëm; pranimi i vendimit nuk është në kundërshtim me rendin publik të Maqedonisë së Veriut, etj.)* do të njihet edhe pse një procedurë falimentimi është ngritur në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas parashikimit të nenit 321 paragrafi (1) ose (2) të këtij ligji.¹⁴² *Paragrafi 1: (gjyqi është kompetent për zbatimin e procedurës së falimentimit kundër debitorit falimentues nëse i njëjti ka njësi afariste pa cilësi të personit juridik në Maqedoninë e Veriut; paragrafi 2: nëse në Maqedoninë e Veriut nuk gjendet kryesisht veprimtaria afariste, si dhe nuk gjendet njësia afariste e debitorit falimentues, por vetëm prona e tij, procedura falimentuese mund të inicohet në këto raste - kur në shtetin në të cilin Debitori i Falimentimit ka një veprimtari biznesi, procedurat e falimentimit ndaj tij nuk*

¹⁴¹ Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, nenet 337 dhe 338

¹⁴² Po aty; neni 337

*mund të hapen për shkak të kushteve të përcaktuara në Ligjin e Falimentimit të këtij shteti, megjithëse ekziston një arsye e falimentimit; nëse sipas ligjit të shtetit në të cilin Debitori i Falimentimit ka një veprimtari mbizotëruese të biznesit, procedura e falimentimit do të mbulojë vetëm pronën e Debitorit të Falimentimit në atë shtet; nëse hapja e procedurës së falimentimit në Republikën e Maqedonisë është propozuar në bazë të të këtij ligji dhe nëse hapja e një procedure të veçantë falimentimi në Republikën e Maqedonisë është propozuar në procedurë për njohjen e një vendimi të huaj për hapjen e shkallës së falimentimit).*¹⁴³ Një vendim i njohur i huaj për hapjen e një procedure falimentimi do të ketë efektin e parashikuar në dispozitat e neneve 346 deri 350 të këtij ligji ku jepen kornizat e dhënies së autorizimit të drejtorit të huaj falimentues, përmbushja e obligimeve ndaj kreditorëve, rregullat e procedurës së veçantë falimentuese në vend të huaj, potencimi i kërkesave që rrjedhin nga procedura e huaj falimentuese si dhe bashkëpunimi i kujdestarëve falimentues. Drejtori i huaj i falimentimit nuk mund të kundërshtojë pretendimet e përcaktuara tashmë në procedurën e filluar më parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nëse në ditën e paraqitjes së propozimit për njohjen e vendimit të huaj për fillimin e procedurës së falimentimit, skadon afati prej 15 ditësh nga dita e shpërndarjes paraprake të pasurisë së falimentimit në procedurën e falimentimit të hapur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shpërndarja nuk do të zbatohet në bazë të vendimit për shpërndarjen i marrë në procedurën e falimentimit të huaj.¹⁴⁴

7. Njohja pa pasoja nga hapja e vendimit të huaj në Maqedoninë e Veriut

Vlefshmëria e një vendimi të njohur të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit përcaktohet me ligjin e shtetit në të cilin hapet procedura, përveç nëse është në kundërshtim me parimet themelore të ligjit për falimentim në Republikën e

¹⁴³ Ligji për falimentim i RMV,(2006 – 2014),” Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, neni 337

¹⁴⁴ Po aty

Maqedonisë së Veriut dhe përveç nëse me kusht nuk parashikohet ndryshe nga ky ligj. Vendimi i njohur i huaj vlen nga dita e shpalljes së vendimit për njohjen në bordit e njoftimeve në gjykatë, sipas nenit 334 paragrafi (4) të këtij ligji. *(Njoftim për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit do të publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Njoftimi gjithashtu do të publikohet edhe në panelin e njoftimeve në gjykatë).* Zgjidhjet e realizuara përmes procedurave përmbarause në Republikën e Maqedonisë së Veriut ndërmjet ditës së hapjes së procedurës së huaj të falimentimit dhe ditës së shpalljes së njoftimit për propozimin për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit në tabelën e njoftimeve, në përputhje me nenin 332 paragrafi (1) i këtij ligji *(pas pranimi të sugjerimit për pranim të vendimit të huaj, gjyqi pa zgatur kohë duhet të bëjë publikimin në Gazetën Zyrtare dhe në panelin e njoftimeve të gjyqit)*, si dhe të drejtat e ndryshme që rrjedhin nga një procedurë përmbarimi ose një procedurë sigurie në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ndodhi gjatë asaj kohë, humbasin efektin e tyre juridik. Në rast të humbjes së veprimit juridik nga paragrafi (1) i këtij neni, kreditori është i detyruar t'i dorëzojë Administratorit të Falimentimit atë që e ka fituar në bazë të kësaj, pasi të ketë minusuar shpenzimet e bëra në procedurën përmbarimore gjegjësisht procedurën e sigurisë.¹⁴⁵

8. Njohja e vendimit të huaj me pasoja për hapjen e procedurës falimentuese në Maqedoninë e Veriut

Në propozimin për njohjen e vendimit të huaj për fillimin e procedurës së falimentimit, i besuari i huaj i falimentimit(drejtori falimentues) ose kreditori mund, si pasojë e menjëhershme juridike e njohjes, të kërkojë hapjen e procedurës së falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Drejtori falimentues gjithashtu mund të kërkojë hapjen e një procedure speciale të falimentimit në Republikën e

¹⁴⁵ Ligji për falimentim i RMV,(2006 – 2014)," Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, neni 337

Maqedonisë së Veriut duke e paraqitur atë në gjykatë brenda 15 ditëve nga data e pranimit të shkrimit. Kreditori gjithashtu mund të kërkojë fillimin e procedurave të tilla të falimentimit duke paraqitur një kërkesë në gjykatë në pajtim me nenin 331 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji (*Gjykata kompetente sipas detyrës zyrtare përcakton që propozimi për njohjen e një vendimi të huaj për hapjen e procedurës së falimentimit, si dhe vendimi për masa të përkohshme, përkatësisht për emërimin e një administruesi të përkohshëm, duhet të regjistrohet menjëherë në një libër publik përkatës ose regjistër*). Në paragrafin (1) të këtij neni, pasojat juridike përcaktohen vetëm me Ligjin e Falimentimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç nëse parashikohet ndryshe në nenet 322 deri 326, ku janë dhënë rregullativat fillestare, marrëveshjes për punë, mënyra e kalkulimeve, bashkëpunimi i kujdestarëve, etj., dhe 345 deri 350 të këtij ligji ku jepen udhëzimet për procedurën e veçantë falimentuese në Maqedoniën e Veriut, autorizimin e kujdestarit të huaj falimentues, përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve, procedurës së veçantë në shtet të huaj, etj. Në këtë rast, nenet 339 deri 342 të këtij ligji që mes tjerash kanë të bëjnë me pronën e debitorit falimentues dhe shërbimeve në favor të të njejtit, zbatohen në përputhje me rastin konkret.¹⁴⁶

9. Hapja e procedurës së veçantë në Maqedoni të Veriut si pasojë e njohjes së vendimit të huaj mbi hapjen e procedurës falimentuese

Gjykata do të hap procedurë falimentuese me propozim të: Fondit kompetent për Sigurim Shëndetësor dhe Fondit kompetent pensional, për kërkesat që janë ligjërisht të detyrueshme të ndahen nga të ardhurat ose paga, si dhe autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe njësitë e saj të vetëqeverisjes lokale dhe Zyrën e të ardhurave publike; dhe arkëtime të tjera që përfshihen si të ardhura në buxhet dhe punonjësit e Debitorit të Falimentimit me pozitë të përhershme të qëndrimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.¹⁴⁷ Me propozimin e kreditorëve që nuk u përkasin kreditorëve nga paragrafi (1) i këtij neni, gjykata hap procedurën e falimentimit në Republikën e

¹⁴⁶ Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14, neni 344

¹⁴⁷ Po aty, neni 345

Maqedonisë së Veriut vetëm nëse kreditori pretendon që shlyerja e disa kërkesave në procedurën e huaj të falimentimit do të shoqërohej me vështirësi të veçanta. Me përjashtim të përcaktimit në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje më të drejtë dhe të plotë të kreditorëve në nivel ndërkombëtar, gjykata nuk do të hap procedurë falimentimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëse konsideron se hapja e një procedure të tillë, duke pasur parasysh madhësinë e pretendimeve të kreditorëve të përmendur në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, do të ishte i pajustificuar ekonomikisht. Gjatë vlerësimit, gjykata mund të këshillohet me një administrues të huaj falimentimi.¹⁴⁸ Nëse kreditori zgjidh pjesërisht kërkesat në lidhje me procedurën e veçantë të falimentimit që është e hapur ndaj debitorit të falimentimit në një vend të huaj, i cili përfshin vetëm pronën e debitorit të falimentimit në atë shtet të huaj, ai mund të mbajë atë që ka pranuar. Pas minusimit të shpenzimeve që ka bërë kreditori për shlyerjen e procedurës së falimentimit të huaj, aplikimi në atë procedurë llogaritet si përqindje që i përket procedurës speciale të falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Nuk do të ketë llogaritje të tillë nëse kreditori do të kishte bërë një zgjidhje të pjesshme në atë procedurë falimentimi të huaj si një debitor i kredituar ose në bazë të kompensimit të lejueshëm. Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni zbatohen edhe kur kreditori e ka zgjidhur pjesërisht kërkesën e tij me anë të procedurave përmbarimore në një shtet të huaj.¹⁴⁹

10. Mospranimi i vendimeve të huaja për hapjen e procedurës falimentuese

Nëse gjykata hedh poshtë propozimin për njohjen e vendimit të huaj për hapjen e së procedurës së falimentimit, me propozimin e kreditorëve ose të debitorit të falimentimit, nëse është e nevojshme për zgjidhjen e barabartë të të gjithë debitorëve, ajo hap procedurën e falimentimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Propozimi nga

¹⁴⁸ Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14 neni 345

¹⁴⁹ Po aty

paragrafi (1) i këtij neni mund të paraqitet brenda tetë ditëve nga data e publikimit të vendimit që refuzon propozimin për njohjen e vendimit të huaj në tabelën e njoftimeve në gjykatë dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ky propozim mund të paraqitet në gjykatë, në përputhje me nenin 332 paragrafi (1) pika 4 të këtij ligji *ku potencohet ftesa ndaj kreditorëve, ndaj debitorit të huaj falimentues dhe ndaj të gjithë atyre që kanë interes ligjor, që në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të njoftimit në Gazetën Zyrtare t'i paraqesin para gjyqit kërkesat e tyre dhe gjatë paraqitjes të deklarohen për ekzistimin e supozimit për pranimin e vendimit të huaj dhe vështirësive tjera të mundshme për plotësimin e kërkesave që rrjedhin nga procedura e huaj falimentuese.* Procedura e falimentimit nga paragrafi (1) i këtij neni përfshin vetëm pasurinë e Debitorit të Falimentimit, i vendosur në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Debitori i huaj i falimentimit, administruesi i falimentimit të huaj dhe kreditorët kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër vendimit që refuzon propozimin për njohjen e një procedure të falimentimit të huaj në një afat prej tetë ditëve nga marrja e vendimit. Ankesa nuk ndalon realizimin e këtij vendimi.¹⁵⁰

11. Falimentimi ndërkombëtar dhe plani për riorganizim

Riorganizimi është ristrukturim i korporatës me qëllim të vazhdimit të veprimtarisë në mënyrë efektive duke ndryshuar statutin e organizatës, modelin e pronësisë, strukturën menaxhuese etj. Korporatat e mëdha e quajnë riorganizimin e ndërmarrjes afariste si “heqje të dhjemit”. Siç e tregon edhe ky term, pronari duhet të zvogëlojë shpenzimet pa e sakrifikuar cilësinë e produkteve ose integritetin e shoqërisë tregtare. Edhe shoqëritë e vogla tregtare mund të përdorin metodat e riorganizimit, por ato shpesh kanë më shumë vështirësi. Fushat të cilat duhet t'i heq pronari janë më pak të dukshme. Përveç kësaj, shoqëritë e vogla tregtare kanë larmi më të vogël. Nëse

¹⁵⁰ Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), ”Gazeta Zyrtare e RMV” nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14 neni 352

pronari bën gabim dhe i heq fushat e gabuara, ai mund ta shkatërroi tërë shoqërinë e tij tregtare. Planin e riorganizimit mund të sigurojë një status të gradës më të ulët për kreditorët e falimentimit dhe status të gradës më të lartë për kreditorët pretendimet e të cilëve lindin nga huaja ose kredi të tjera të zgjeruara gjatë mbikëqyrjes mbi zbatimin e planit të riorganizimit të debitorit ose ndërmarrjes tregtare ose personit tjetër juridik që ka marrë përsipër veprimtarinë e biznesit të debitorit.¹⁵¹

Planin e riorganizimit të debitorit falimentues mund ta konsiderojmë si një nga institutet më të rëndësishme për të evituar falimentimin e debitorit, duke ofruar mundësi për kompensim të kreditorëve në kushte dhe mënyra të përcaktuara në bazë të dispozitave ligjore. Procedura e falimentimit e cila në vete ngërthen edhe elementin e riorganizimit, gjen zbatim duke u bazuar tek plani i riorganizimit i cili formulohet në formë të shkruar. Me përmbushjen e kushteve të përcaktuara me ligj, plani i tillë mund të paraqitet pas hapjes së procedurës falimentuese apo para hapjes së procedurës. Subjektet të cilat kanë autorizim për të paraqitur planin e riorganizimit e kanë si detyrë që gjyqtarit të falimentimit t'i paraqesin planin e përmendur më së voni brenda 45 ditëve nga dita e pranimin të autorizimit.¹⁵²

Dispozitat ligjore përcaktojnë mënyrën e riorganizimit dhe ato: me lejin e mundësisë që debitorin të menaxhojë ose ta ketë në dispozicion tërë pasurinë ose vetëm një pjesë të pasurisë së tij; me zbatimin e ndryshimit përkatës statusor; me bashkimin e debitorit me një apo më shumë persona; me shitjen e tërë pasurisë së debitorit apo një pjese të saj; me ndarjen e tërë pasurisë apo një pjese të saj ndërmjet kreditorëve; me përcaktimin e mënyrës së përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorëve të falimentimit; me përmbushjen apo ndryshimin e të drejtave në përmbushje të ndarë; me zvogëlimin apo shtyerjen e obligimeve të debitorit, etj.¹⁵³

Planin për riorganizim përbëhet nga dy faza, atë përgatitore dhe atë zbatuese. Në të parën përshkruhen masat që janë marrë dhe ato që duhet të ndërmerren pas hapjes së një procedure të falimentimit. Faza e dytë përfshin masa dhe mjete për realizimin e

¹⁵¹ *The Southeast Europe Restructuring & Insolvency Guide* (2016); Shkup, fq. 120

¹⁵² Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq. 392

¹⁵³ Po aty, fq. 393

planit si dhe ofron një përshkrim të hollësishëm të masave që duhet të ndërmerren dhe mënyra e realizimit të riorganizimit.¹⁵⁴

Plani i riorganizimit duhet të përcaktojë të drejtat e pjesëmarrësve në grupe dhe duhet të bëjë dallim në mes të:

- Kreditorëve me të drejtë në përmbushjen e detyrimeve në mënyrë të ndarë, si dhe
- Kreditorëve nga vendi më i lartë i listës së pagimit, nëse të drejtat e tyre janë prekur nga një plan i tillë riorganizimi.¹⁵⁵

Miratimi dhe lejimi i planit bëhet nga kuvendi i kreditorëve të cilët konvokohen nga gjyqtari i falimentimit për të votuar për një afat jo më të shkurtër se 21 ditë. Gjyqtari shpall datën e kuvendit dhe do të potencojë se plani i riorganizimit dhe prononcimet e pranuar janë të arritshme për shqyrtim. Të drejtë për të votuar kanë vetëm ata kreditorë që kanë bërë kërkesë dhe që nuk janë të kontestuar debitorit falimentues apo ata kreditorë nga rangu më i ulët pagesor.¹⁵⁶

Pas miratimit të planit për riorganizim, kërkohet vendim që votohet me shumicë e cila është e përcaktuar me ligj.¹⁵⁷

Në momentin kur plani bëhet i plotfuqishëm, rregullat nga pjesa e përmbajtjes të planit bëhen të domosdoshme për të gjithë pjesëmarrësit.¹⁵⁸

Kur pjesa përmbajtësore e planit parashikon se pas përmbylljes së procedurës së falimentimit drejtori i falimentimit, gjegjësisht kontrollori do të bëjë mbikqyrje mbi zbatimin e atij plani, fakt ky i cili do të shpallet bashkë me aktvendimin me të cilin gjyqtari do të bëjë përmbylljen e procedurës së falimentimit.¹⁵⁹

¹⁵⁴ Jashari, A. (2012); *E drejta afariste* (statusore); Tetovë; fq 394

¹⁵⁵ Po aty, fq. 395

¹⁵⁶ Po aty, fq. 396

¹⁵⁷ Po aty, fq. 397

¹⁵⁸ Po aty, fq. 398

¹⁵⁹ Po aty, fq. 401

REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE NË LIDHJE ME FALIMENTIMIN NDËRKOMBËTAR

Sipas Raportit nga Instituti për politikë europiane (2016) gjëja e parë që duhet bërë padyshim se është përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor që ka të bëjë me qasjen e lirshme ndaj informatave të nevojshme të cilat në masë të madhe do të ndihmonin ekzekutimit e procedurave falimentuese ndërkufitare të transferimit dhe bashkimit. Kjo thekson nevojën që shumica e institucioneve në Republikën e Maqedonisë së Veriut të vazhdojnë me aktivitetet e tyre në këtë drejtim, ku me siguri se do të ndihmonin hapat në vijim, numri më i madh i të cilave sugjerohen edhe nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim. Rekomandimet nga raporti në gërshetim me atë që unë personalisht besojë, do të ishin si në vijim:

- Potencimi i nevojës për negocime të mëtutjeshme dhe nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunimin gjyqësor, përkatësisht për ndihmën juridike ndërkombëtare si dhe të lidhen protokolle për bashkëpunim ndërkufitar midis institucioneve;
- Të bëhet një rishikim i procedurave që theksojnë realizimin e ndihmës juridike ndërkombëtare, duke synuar që kështu të punohet në drejtim të thjeshtëzohen instrumentet për bashkëpunim ndërkufitar; të analizohet se a mundet gjuha angleze të përdoret gjatë ndihmës juridike ndërkombëtare;
- Të theksohet domosdoshmëria e aktivitetit më të madh të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në temat e bashkëpunimit në organet e jurisprudencës për çështje që i tangojnë kësaj çështjeje;
- Në vazhdimësi të bëhet trajnim i rregullt i përfaqësuesve diplomatikë për çështjet kyçe që kanë të bëjnë me procedurat falimentuese të cilat do të ndihmonin bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, ku mund të cekim dërgesa e dokumenteve, ndërsa në këtë drejtim të parashikohen protokolle në të cilët në mënyrë të saktë do të përpunohen veprimet e caktuara të institucioneve përkatëse;

- E dimë se dekadave të fundit gjuha angleze dhe aftësimi për punë me kompjuter është bërë një çështje me rëndësi mjaftë të madhe, prandaj inkorporimi i trajnimit për këto lëmi do të duhet të jetë i detyrueshëm për gjyqtarët dhe nëpunësit gjyqësorë;
- Që puna të ec në shpejtësinë e duhur padyshim se nevojitet instalimi i softuerit adekuat dhe bazës së të dhënave dhe i statistikës për monitorimin e rasteve të ndihmës juridike ndërkombëtare i cili do të ofronte menaxhim digjital të dokumentacionit përkatës;
- Të sigurohen informacione edhe për realizimin e indikatorëve kualitativ për matjen e progresit;
- Të potencohet rëndësia për komunikim të vazhdueshëm me institucionet kompetente të BE të cilat e mbajnë regjistrin e falimentimit, bashkimit dhe transferimit me qëllim të shkëmbimit të informacioneve ndërmjet shteteve;
- Të lehtësohet qasja ndaj informacioneve për rastet e falimentimit;
- Sa më shumë të stimulohet bashkëpunimi ndërkufitar midis dhomave ekonomike, me qëllim të shkëmbimit të informacioneve;
- Vëmendje të posaçme t’i përkushtohet sigurisë juridike, nga fakti se gjithmonë kemi ndryshime të shumta nga pikëpamja juridike;
- Të ekzistojë transparencë e plotë ndërkombëtare në lidhje me procedurat e falimentimit me qëllim të evitimit të pengesave të mundshme të cilat do të bllokoni proceset e tilla;
- Nga ana tjetër, nevojitet të sensibilizohet edhe opinioni publik në lidhje me rëndësinë e kësaj materie si dhe të stimulohen shoqatat qytetare, fillimisht asociacionet afariste ta ndjekin aktivitetin e bashkëpunimit të organeve të jurisprudencës, veçanërisht në fushën e çështjeve ekonomike, siç janë ekzekutimet, bashkimet, falimentimet dhe transferimet ndërkufitare.

ZHVILLIMET E FUNDIT

Siç edhe kemi cekur deri tani procedurat ligjore, pa marrë parasysh a kanë të bëjnë me çështjen e falimentimit apo me ndonjë dispozitë tjetër, të gjitha janë në lëvizje të vazhdueshme dhe në ndryshim konstant. Në vijim do të theksojmë disa nga zhvillimet kyçe në lidhje me objektin tonë të studimit bazuar në raportin për politikë evropiane të vitit 2016. Duke filluar nga muaji Qershor i vitit 2016 u aktualizua rasti i tentativës për transferimin e SHA Makpetroll nga ana e Balkan Petroleum Holding Limited – Kompani qipriote e cila përmes një konkursi në media e shpalli qëllimin për transferimin e Makpetrollit. Mediat, në mënyrë aktive, i ndiqnin ndodhitë në lidhje me këtë gjendje dhe raportuan se kompania është themeluar para jo më shumë se 12 ditë në Londër, me seli në Qipro. Mes tjerash, u raportua se ajo ka dy të punësuar dhe është themeluar me kapital themelor prej 1.000 (një mijë) euro. Sa u përket aksioneve të Makpetrollit, të cilat në bursë shiten me çmim prej 17.000 denarë, kompania ofroi 25.908 denarë. Bordi drejtues i Makpetrollit e shqyrtoi shkresën e Balkan Petroleum Limited dhe vendosi se për të njëjtën nuk mund të veprohet. Qëndrim të ngjashëm kishte edhe Bursa e Maqedonisë së Veriut, që thekson se edhe tek ata është dërguar shkresë me përmbajtje të njëjtë. Shkresës së Balkan Petroleum nuk i është bashkëngjitur autorizimi përkatës në bazë të të cilit do të konstatohet legjitimiteti i personit të autorizuar që të paraqitet në emër të shoqërisë, dhe për këtë shkak Bursa e Maqedonisë së Veriut nuk e shqyrtoi këtë lëndë. Përndryshe, vlera kontabël e një aksioni të SHA Makpetroll është 30.250 denarë. Sipas çmimit të ofruar prej 25.908 denarë, kjo do të thotë se “Balkan Petroleum” duhet të sigurojë garanci prej rreth 47 milionë euro.¹⁶⁰

Gjatë muajit Shtator vazhdoi interesimi i publikut për transferimin e mundshëm të “Makpetroll” SHA Shkup nga ana nga "Balkan Petroleum Holding Limited". Komisioni për letra me vlerë i Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbledhjen e 98 të mbajtur më datë 19 Shtator të vitit 2016, miratoi Konkluzion për ndërprerjen e procedurës së ngritur sipas kërkesës për lëshimin e lejes për ofertën e transferimit të “Makpetroll” SHA

¹⁶⁰ Raport - Instituti për politikë evropiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë* ; Shkup; fq. 12

Shkup të paraqitur nga "Balkan Petroleum Holding Limited". Siç njoftoi Komisioni, procedura është ndërprerë për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake tek një organ tjetër kompetent shtetëror, dhe pas kësaj procedura do të vazhdoj.¹⁶¹

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, më datë 24 dhe 25 Nëntor të vitit 2016, bashkë me Fondin e Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – reforma juridike (GIZ) organizoi konferencë rajonale në temë: “Përforcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të jurisprudence nga vendet e Ballkanit Perëndimor”. Qëllimi i kësaj konference rajonale është t'i bashkojë drejtorët e institucioneve për trajnimin e jurisprudence nga Ballkani Perëndimor dhe përmes prezantimeve të të arriturave të shkëmbehen ide për përforcimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve. Më datë 15.11.2016, në kuadër të Projektit IPA 2010 për mbështetjen e mëtutjeshme të gjyqësorit të pavarur, të përgjegjshëm, profesional dhe efikas dhe avancimin e shërbimit të provës dhe të masave alternative, në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut u organizua prezantim dhe tryezë e rrumbullakët me temën: “Si të shndërrohen të dhënat në njohuri të aplikueshme dhe efektive.” U konstatua se për shkak të implementimit të suksesshëm të mënyrave të prezantuara të matjes së rezultateve në drejtim të monitorimit të performancave gjyqësore dhe përmirësimit të tyre nevojitet sistemi i AKMIS (sistem i automatizuar për trajtimin e lëndëve në gjykata) në Republikën e Maqedonisë së Veriut të mbindërtohet me aplikacione përkatëse softuerike.¹⁶² Në organizim të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, ndërsa në bashkëpunim me Fondin e Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – reforma juridike (GIZ) Shkup, më datë 24 Nëntor të vitit 2016 u organizua konferencë dyditore rajonale “Përforcimi i bashkëpunimit midis institucioneve të jurisprudence nga vendet e Ballkanit Perëndimor”, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të efikasitetit dhe cilësisë së trajnimeve. Në këtë konferencë u mbajt edhe takimi i Këshillit Rajonal për Bashkëpunim.¹⁶³ Në konferencë morën pjesë tetë drejtorë të akademive të jurisprudence nga Evropa Juglindore dhe Turqia, përfaqësues nga

¹⁶¹ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 12

¹⁶² Po aty

¹⁶³ Po aty

Akademia për të Drejtën Evropiane (EPA) dhe nga Programi HELP pranë Këshillit të Evropës dhe Sekretari i Përgjithshëm i Rrjetit Evropian për Trajnime të Jurisprudencës (EJTH).¹⁶⁴

Numri më i madh i ligjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët e rregullojnë materien e bashkëpunimit ndërkombëtar, në esencën e tyre janë të mirë. Më së shpeshti problemet kanë të bëjnë me implementimin. Falimentimi nxit interesim më të madh. Shkalla e kompenzimit të kërkesave të falimentimit është e ulët, rreth 47,5%, ndërsa në vendet e OECD kjo përqindje është rreth 75%. Së këtejmi, bëhet fjalë për kërkesa të siguruara, ndërsa mbulimi i kërkesave të pasiguruara është akoma më i ulët. Ka baza të të dhënave të mangëta nga procedurat e falimentimit, e që e pamundëson analizën e mirë dhe ndryshimin eventual të disa elementeve të sistemit, me të cilët mund të përmirësohet efektiviteti i procedurave të falimentimit.¹⁶⁵

Fitimi i informacioneve cilësore nevojitet për biznesin e rajonit, ndërsa dhomat mund të jenë qendra të një numri të madh të informacioneve të këtilla. Ato hartojnë edhe studime të ndryshme, analiza, aktivitete B2B dhe anëtarëve të tyre mund t'ju sigurojnë informacione për çështje ndërkufitare dhe për partner potencial. Gjithashtu, ato kanë mundësi që anëtarëve të dhomave të huaja t'u ndihmojnë gjatë paraqitjes në tregjet vendorë dhe ato një gjë të këtillë e bëjnë brenda mundësive të tyre. Në Ministrinë e Drejtësisë zhvillohet një projekt i ri për ndihmë juridike ndërkombëtare, për sigurimin e informacioneve të mira të proceseve ndërkombëtare, siç janë: koha e zhvillimit, sa kohë kanë zgjatur proceset dhe disa specifika të tyre. Përgatitjet edhe softueri i cili do ta lehtësoj evidentimin dhe monitorimin.¹⁶⁶ Bashkëpunimi në proceset gjyqësore lehtësohet me bashkëpunimin përmes marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale. Me të njëjtat përcaktohet se si njihen vendimet e huaja gjyqësore në të drejtën vendore.¹⁶⁷ Me fjalë të tjera, shumë probleme me të cilat ballafaqohen subjektet lokale ose subjektet e huaja kur duhet të ekzekutojnë një vendim të huaj në

¹⁶⁴ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë* ; Shkup; fq. 12

¹⁶⁵ Po aty, fq. 13

¹⁶⁶ Po aty

¹⁶⁷ Po aty

një vend të tretë. Komunikimi rrjedh përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, ndërsa në këtë drejtim ndihmë të madhe ofron Ministria e Drejtësisë.¹⁶⁸

Subjektet e ekzekutimit ndërkufitar, po ashtu, ishin objekt i diskutimit dhe interesimit. Një problem të veçantë gjatë ekzekutimit paraqet dërgesa e dokumenteve deri te qytetarët maqedonas të cilët kanë vendqëndrim jashtë vendit, për shkak të afateve të shkurtra të cilat janë përcaktuar në Ligjin për përmbarim të RMV. Në ato raste në të cilat ka marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi mund të shkojë përmes gjykatave, ndërsa rezultatet janë shumë më të mira prej atyre vendeve në të cilat shfrytëzohen përfaqësitë konsullore. Ministria e Drejtësisë ofron ndihmë të shkëlqyeshme në rastet kur paraqiten probleme. Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral i shoqërive afariste, dhomave, organeve rregullatore (Komisioni për Letra me Vlerë përmes IOSCO) dhe asociacionet profesionale, (Dhoma e Përmbaruesve përmes Asociacionit Evropian dhe dhomave nga fqinjësia) Dhoma e Drejtorëve të Falimentimit përmes dhomave ndërkufitare po ashtu ndihmon për një shkëmbim më të thjeshtë të informacioneve dhe për realizimin më të lehtë të proceseve të bashkëngjijtes, bashkimit, transferimit, falimentimit dhe ekzekutimit.¹⁶⁹

¹⁶⁸ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 13

¹⁶⁹ Po aty

KRIMI DHE FALIMENTIMI

Çështjet e krimit të lidhura me falimentimin dhe procedurat e falimentimit janë të dukshme për publikun e gjerë, pasi pothuajse çdo procedurë e falimentimit është, për fat të keq, e lidhur me kallëzime penale. Problemi kryesor në lidhje me zbulimin dhe ndjekjen me sukses të këtyre krimeve është legjislacioni i ndërlikuar në këtë fushë. Jo vetëm që e drejta civile është e ndërlikuar siç aplikohet në procedurën falimentuese, por ligjet përkatëse nga fushat e tjera, përfshirë të drejtën penale, nuk janë të koordinuara, kështu që procedura mund të manipulohet lehtësisht. Procedura e falimentimit është miratuar për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat dhe interesat e kreditorëve, si dhe debitorit falimentues që nuk është në gjendje të paguajë në kohë borxhin e tij. Kjo procedurë shpesh shoqërohet me të ashtuquajturën "kulturë shpëtimi", me anë të të cilit rristrukturohen financat e kompanisë për të shpëtuar atë nga dështimi dhe për të ndihmuar ata që janë të interesuar për falimentimin në fjalë, palët e interesuara, investitorët, kreditorët ose punonjësit, të rimarrin disa nga ato që i detyrohen.¹⁷⁰ E gjithë kjo jep mundësinë për të kriminalizuar procedurën.

Autorë të shumtë i ndajnë krimet e falimentimit në dy grupe: krime të falimentimit të kryera para fillimit të procedurave dhe krime të falimentimit të kryera pas fillimit të procedurave të falimentimit.

Grupi i parë përfshin krimet e "Krijimit të qëllimshëm të falimentimit" dhe "Shkaktimit të falimentimit nga një veprim i paskrupullt", dhe grupi i dytë përfshin "Shpërdorimin e procedurës së falimentimit" dhe "Dëmtim ose privilegjim të kreditorëve".¹⁷¹

E gjithë kjo në të shumtën e rasteve ndikon ndër të tjera edhe në stërgjatjen e procedurave falimentuese të cilat në Maqedoninë e Veriut ndodhin edhe për shumë shkaqe tjera si fakti se inicohen procedura me kërkesa të dyshimta, nuk paraqiten blerës

¹⁷⁰ Kosevaliska, O. (2016); Tusevska, B.; *Crimes of Criminal Insolvency in Macedonian Legislation*; Shkup; fq. 2

¹⁷¹ Po aty

apo tenderë adekuat, kur fillohen procedura në të cilat nevojiten edhe dokumentacione nga kadastra, etj.¹⁷²

¹⁷² Ristov, D.; (2011) *Priçini za dolgoto traenje na stečajnite postapki vo Makedonija*; Shtip; fq. 65

KREU IV

1. Analiza e të dhënave empirike dhe statistikore në lidhje me falimentimin ndërkombëtar në RMV, nga viti 2017 e këndej.

Sipas të dhënave të marra nga Regjistri qendror i Maqedonisë së Veriut nga 3 Janari i vitit 2017 e deri më 22 Gusht të 2019, konstatova se të dhënat statistikore tregonin informata për procedura të mbyllura apo ende të hapura të falimentimit për 3281 ndërmarrje afariste nga të cilat për vetëm 5 potencojë se ka interese financiare nga subjekte jashtë kufinjve të Maqedonisë së Veriut. Kjo tregon për një dallim jashtëzakonisht të madh ndërmjet ndërmarrjeve vendore dhe atyre me burime nga jashtë. Një gjë e tillë u cek edhe më lartë ku u tha se nuk është edhe aq i madh numri i procedurave falimentuese me theks ndërkombëtar. Sipas Regjistrisë qendrore, këto janë kompanitë që i tangojnë temës sonë të studimit:

1. **Sardiç MC DOOEL** (n.a. 6923542) nga Shkupi, procedura e së cilës është hapur më 25 Mars të vitit 2019 dhe është lëndë e gjykatës themelore Shkupi 2; drejtor i falimentimit: Vladica Ivanovska. Në këtë rast konkret interese financiare ka edhe ndërmarrja Kopera Limited nga Gjibraltari e cila është përfaqësuar nga personi Genadij Siçov. Sipas regjistrisë qendrore, procedura është ende e hapur.¹⁷³
2. **Stefan Vajneri DOO** (n.a. 6731619) nga Kavadar, procedura e së cilës është hapur më 28 Maj të vitit 2019 dhe është lëndë e gjykatës themelore Gostivar; drejtor falimentimi: Gjoko Stojkovski. Në këtë procedurë interese ka edhe Rizzi GMBH Food and Drinks Ausenhaldelslogistik, rr. Beppo-Brem-Veg 8. Pulah im Isartal, Gjermani. Ndërmarrja në fjalë ka interes financiar në vlerë prej 120 385 936 denarë. Sipas Regjistrisë qendrore, procedura është ende e hapur.¹⁷⁴

¹⁷³ [http://e-submit.crm.com.mk/eBankruptcyPublic/,\(2010-2015\)](http://e-submit.crm.com.mk/eBankruptcyPublic/,(2010-2015))

¹⁷⁴ Po aty

3. **Nova Logistik DOOEL** (n.a. 6314457) nga Vozarci i komunës së Kavadarit, procedura e së cilës është hapur më 7 Gusht të vitit 2018 dhe është lëndë e gjykatës themelore të Velesit; drejtor i falimentimit: Dimitar Axhiev. Në këtë procedurë interesa ka edhe Mining Fero Nikel nga Shqipëria e cila është si debitor dhe ka kërkuar zgjatje të afatit për realizimin e kontratës për pagesë në përputhje me vendimin e mbledhjes së të besuarve që është mbajtur më 06.06.2019. Sipas të dhënave nga Regjistri qendror procedurë ende nuk është mbyllur.¹⁷⁵
4. **Vilan-ASS DOOEL** (n.a. 6161588) nga Saraj i Shkupit, procedura e së cilës është hapur më 7 Nëntor të vitit 2017, lënda e së cilës është nën ingerencat e gjykatës themelore Shkupi 2; drejtor falimentimi: Hristina Jonovska. Në këtë procedurë interesa ka edhe Johann Zsifkovicz GMBH & Co. KG. Sipas të dhënave nga Regjistri qendror procedura nuk është e përmbyllur.¹⁷⁶
5. **Graficki Centar DOO** (n.a. 5313945) nga Karposhi i Shkupit, procedura falimentuese e së cilës është hapur më 22 Maj të vitit 2017, dhe është lëndë e gjykatës themelore Shkupi 2; drejtor falimentimi: Aco Petrov. Në këtë procedurë interesa ka edhe Poligraf Snab AD nga Sofja. Procedura është ende e hapur.¹⁷⁷

Këtu mund të përmendim edhe faktin se në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kohëve të fundit, njihet vetëm një rast i procedurës së hapur të falimentimit mbi filialin e një kompanie të huaj të themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa selia kryesore ndodhet në Austri dhe quhet Kompania Alpine Bau GMBH, e njohur në botë si korporatë ndërtimore e dyta për nga madhësia në Austri. Me fjalë të tjera, më datë 19.06.2013 gjykata kompetente në Austri, sipas propozimit të paraqitur nga organet e administrimit të kompanisë, hapi procedurë falimentimi. Si pasojë e procedurës së falimentimit të hapur në Austri, drejtori i falimentimit të Alpine Bau GMBH kërkoi të


¹⁷⁵ [http://e-submit.crm.com.mk/eBankruptcyPublic/,\(2010-2015\)](http://e-submit.crm.com.mk/eBankruptcyPublic/,(2010-2015))

¹⁷⁶ Po aty


¹⁷⁷ Po aty

hapet procedurë falimentimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas propozimit të drejtorit të huaj të falimentimit, fillimisht është miratuar vendimi i huaj për hapjen e procedurës së falimentimit, ndërsa pastaj u hap procedura e falimentimit ndaj filialit të kompanisë Alpine GMBH në Republikën e Maqedonisë së Veriut.¹⁷⁸

Në vazhdim do të ofrojmë paraqitje grafike të të dhënave të mësipërme.




Grafiku 3. Procedurat sipas gjykatës kompetente




Grafiku 4. Procedura të hapura dhe të mbyllura

¹⁷⁸ Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup; fq. 12



Grafiku 5. Procedurat sipas vitit të hapjes



Grafiku 6. Procedurat sipas selisë së ndërmarrjeve

PËRFUNDIM

Nuk dyshohet se njerëzit mund të arrinë shumë duke vepruar vetëm, por poashtu nuk duhet dyshuar se shumë më tepër mund të arrihet në bashkëpunim me të tjerët. Nevoja për rezultate më kualitative dhe më të shpejta, kërkon bashkëpunim të dy apo më shumë palëve të cilat do të investonin intelektualisht dhe financiarisht që të krijojnë një ndërmarrje stabile. Megjithatë, ekzistimi i palëve të ndryshme në shumë raste domethënë edhe mendime të ndryshme, apo diskutime për investime të caktuara në lëmi të caktuara të cilat partnerët mund t'i shohin me sy të ndryshëm. Kjo mund të ndikojë në dështimin e ndërmarrjes, apo siç e kemi cekur deri më tash, në falimentim. Kjo situatë bëhet edhe më e ndërlikuar kur kemi të bëjmë me raste të cilat kanë partner të huaj, ku për çfarëdo problemi i cili do të rezultonte, për zgjidhjen e tij do të nevojitej edhe involvimi i legjislacioneve të vendeve tjera.

Në punimin tim kam tentuar të sqaroj pikërisht fenomenin e lartëpërmendur, duke ofruar argumente, analiza si dhe statistika adekuate me të vetmin qëllim që ta qartësojmë dukurinë e ndërlikuar të falimentimit ndërkombëtar që paraqet një sfidë mjaftë komplekse, qoftë nga pikëpamja ekonomike, dhe çka na intereson neve edhe më shumë, edhe nga pikëpamja juridike.

E dimë se një nga të drejtat tona bazike është dhënia e mundësisë për një gjykim të pavarur. Prandaj, siç u cek edhe në kapitullin në lidhje me falimentimin dhe krimin, duhet trajtuar mirë çështjen në fjalë duke evituar ndikimet korruptive, të cilat si rezultat do të ndikojnë edhe në marrjen e vendimeve të duhura lidhur me një rast falimentues.

Sidoqoftë, rregulloret e shumta të cilat i kemi përmendur, ligjet përkatëse dhe ajo që ndoshta është edhe më e rëndësishme, vetëdijësimi i palëve të interesuara për fillimin e një biznesi konkret, do të ishin shpresë që në të ardhmen të kemi sa më pak ndërmarrje të cilat do të binin në humnerën e falimentimit, duke krijuar kështu një ambient ekonomik sa më të shëndoshë ku ana juridike do ta ketë më lehtë për t'u përballur me këtë fenomen.

E gjithë kjo si dhe ndërlidhja edhe me rekomandimet që u cekën më parë do të mundësonte një qasje më konkrete ndaj dukurisë së falimentimit e cila në kuadër të zhvillimeve të reja në planin e ekonomisë ndërkombëtare ballafaqohet me sfida të njëpasnjëshme të cilat duhet trajtuar në përputhje me rastet konkrete. Poashtu do të rekomandohet që në të ardhmen kur do të trajtohet një rast falimentues mos të shfrytëzohen ekskluzivisht vetëm të dhëna financiare që u përkasin ndërmarrjeve që janë ballafaquar me falimentimin, por në rast të mundësive të synojmë edhe në përfshirjen e treguesve të ndryshëm makroekonomikë të cilët besoj se në masë të madhe do të ndihmonin procedurën falimentuese. Këtu do të mund të përmendim strategjitë e ndryshme të marketingut, menaxhimi që do duhej të bëhet përgjatë krejt njësive të ndërmarrjes që është në falimentim, duke e ditur se ndërmarrjet e përmasave më të mëdha kanë një numër të konsiderueshëm njësish, secila nga to me detyrime të ndryshme, por që të gjitha takohen në një pikë të përbashkët; theks i veçantë duhet t'i jepet edhe trajtimit të burimeve njerëzore ku duhet shqyrtuar cilësinë e kuadrit në ambientin e punës ngase kuadri cilësor do të ndihmonte në masë të madhe në evitimin e problemeve të shumta që mund ta ndjekin një njësi ekonomike, ku ndër më të rëndësishmet është edhe vet falimentimi. Për të gjitha këto, kur kemi të bëjmë me falimentimin ndërkombëtar, serioziteti bëhet i dyfishtë duke e ditur se atëherë kemi involvim edhe të legjislacioneve të vendeve të tjera.

Zakonisht studentët e ekonomisë dhe të drejtësisë falë studimeve të tyre fatmirsisht janë të informuar mbi këtë proces dhe kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar dhe për t'u përballuar me falimentimin, mirëpo e shoh shumë me rëndësi që sidomos gjeneratat e reja që nuk i studiojnë këto drejtime të njoftohen thellësisht me përparsitë e këtij instituti me të cilin secili nga ne mund të përballlet në një të ardhme të afërt sidomos nëse krijojmë një veprimtari tregtare.

Me rëndësi është që tregtarët para se me themeluar një veprimtari tregtare t'i njohin për së afërmi të gjitha faktoret dhe shkaqet që mund ta dërgojnë në dështimin(falimentimin) e veprimtarisë së tyre.Tregtari duhet që të sigurojë hapsirën e

nevojshme për të punuar, të punësojë kuader të kualifikuar në lëmin e veprimtarisë së tij, t'u shmanget problemeve financiare etj.

Personi që themelon një shoqëri tregtare do ta kisha rekomanduar që fillimisht të njoh mirë tregun, nevojat e tregut dhe industrisë të cilat vazhdimisht ndryshojnë dhe avancohen.

Tregtari që punëson shumë puntor në njesinë e tij afariste duhet që në mënyrë profesionale t'i kontrolloj puntorët e tij, ta menaxhojë biznesin e tij e jo ta lëre pas dore me arsyetim se ka punësuar njerëz për ta bërë këtë. Me fjalë të tjera të punësosh njerëz që kryejnë punën mire dhe me përgjegjësi nuk do me thonë që tregtari që e themelon atë shoqëri tregtare ta lëre biznesin e tij pa një vemendje të vazhdueshme. Prandaj kërkohet një vemendje të madhe si nga ana e themeluesit si nga ana e puntorëve.

Besoj se trajnimi i personave që konsiderohen si fillestar në biznes në lidhje me sfidat e tregut dhe në lidhje me rëndësinë e analizës thelbësore të udhëheqjes dhe vendimmarrjes në kuadër të një ndërmarrjeje afariste, do të ishte një dorë ndihmëse e cila do ta lehtësonte punën e gjitha palëve të involvuara.

BIBLIOGRAFIA

1. Altman, E.I.; Hotchkiss, E. (2005); *Corporate Financial Distress and Bankruptcy: Predict and Avoid Bankruptcy, Analyze and Invest in Distressed Debt*.
2. Bauweraerts, J. (2016); *Predicting bankruptcy in private firms: towards a stepwise regression procedure*; International Journal of Financial Research, Vol. 7, No. 2.
3. Bilalli, A.; Kuçi, H (2012); *E drejta ndërkombëtare private*; Prishtinë.
4. Charan, R.; Useem, J. (2002); *Why companies fail - CEOs offer every excuse but the right one: their own errors*; Fortune.
5. Cotter, A. (ed.) (2003); *Insolvency Law*; Cavendish Publishing Limited.
6. Creditreform Economic Research Unit. (2013); *Corporate Insolvencies in Europe*.
7. Demeska, L. (2010); *Ekonomia për vitin IV*; Shkup.
8. *Doing Business* (2018) – *Reforming to Create Jobs*; World Bank Report; Shkup.
9. Fernandez, G. (2012); *A comprehensive study of bankruptcy prediction: accounting ratios, market variables, and microstructure*; Florida International University.
10. Gaughan, P. A. (2011). *“Mergers, Acquisitions and Corporate Restructuring”*, 3. Edition, John Wiley and Sons Inc., New York.
11. Grier WS, Nicholas (2014), *Bankruptcy in Scotland: Past, Present, and Future*, Scottish Parliamentary Review, Vol. I, No. 2.
12. Jashari, A (2012); *E drejta afariste (statusore)*; Tetovë.

13. Kosevaliska, O. (2016); Tusevska, B.; *Crimes of Criminal Insolvency in Macedonian Legislation*; Shkup.
14. LoPucki, L.; Doherty, J. (2004); *The Determinants of Professional Fees in Large Bankruptcy Reorganization Cases*; Journal of Empirical Legal Studies.
15. Moyer, S. (2005); *Distressed Debt Analysis*; Boca Raton.
16. Numani, E. (2017); *Falimentimi i njësisë ekonomike dhe parashikimi i tij*; Tiranë.
16. Raport - Instituti për politikë europiane (2016); *Monitorimi i qeverisjes në fushën e drejtësisë*; Shkup.
17. Reindl, J.; Stoughton, N.; Zechner, J. (2013); *Market implied costs of bankruptcy*; CFS Working paper.
18. Ristov, D. (2011); *Priçini za dolgoto traenje na stečajnite postapki vo Makedonija*; Shtip.
19. Sharma, S.; Mahajan, V. (1980); *Early Warning Indicators of Business Failure*; Journal of Marketing.
20. Stromberg, P.; Thorburn, K. S. (1996). *"An empirical investigation of Swedish corporations in liquidation bankruptcy"*, EFI Research Report, Stockholm School of Economics.
21. *The Southeast Europe Restructuring & Insolvency Guide* (2016); Shkup.
22. USAID-broshurë (2014); *Programi për përmbardim dhe legjislacion komercial*; Prishtinë.
23. Velkova, S. (2010); *Biznesi për vitin IV*; Shkup.
24. Warner, J. (1977); *"Bankruptcy Costs: Some Evidence"*, Journal of Finance.

25. Wruck, K. H. (1990); *“Financial Distress, Reorganization and Organizational Efficiency”*.

LIGJE DHE BURIME TJERA

26. Ligji për falimentim i RMV, (2006 – 2014), ”Gazeta Zyrtare RMV “ nr. 34/06 (ndryshime në GZ nr. 126/06 deri 29/14).
27. Ligji për mbështetje financiare të investimeve i RMV,(2018), ”Gazeta zyrtare e RMV”n.33.
28. <http://e-submit.crm.com.mk/eBankruptcyPublic/>,(2010-2015).
29. <http://www.economy.gov.mk/>,(2015).
30. <https://www.worldbank.org/>,(2019).
31. “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”
<http://www.slvesnik.com.mk/>.
32. <https://www.britannica.com/topic/bankruptcy>
(Stefan Albrecht Riesenfeld, Contributor),viz,korrik,2019.
33. <https://www.gov.uk/statutory-demands>, viz. korrik, 2019.
34. <https://www.thebalance.com/history-of-bankruptcy-in-the-united-states-316225>
(David Hynes, Contributor), viz, qershor, (2019).